



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS PEJË

I.Numër: 01-060/01-17169

Pejë, datë: 31 Mars 2026

PROCESVERBAL

Nga takimi i **-II- të** i rregulltë i Kuvendit Komunal Pejë, i mbajtur me: **31 mars 2026** me fillim në orën 10:00 h.

Takimi u mbajt në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës.

Në takim prezantojnë: përpos anëtarëve të kuvendit të komunës, nënkryetari z. Fatmir Asllani; kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj; drejtorët e SHCK-së, z. Avni Gashi, udhëheqës i sektorit të kuvendit, zyrtare administrative znj.Donjeta Morina: përfaqësues të ZIP-it, përfaqësuesit të OJQ-ve dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike.

Në vazhdim takimin e kryesoi; kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, ku e hapi diskutimin për rendin e ditës dhe i sqaroi pikat të cilat janë vendosur në rend dite, pastaj konstatoj se janë 34 anëtarë prezent.

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët prezent, u miratua ky rend dite me propozimin që u dha nga kryesuesi:

REND DITE

1. Aprovimi i rendit të ditës.
2. Betimi i anëtarëve të Kuvendit, Leotrim Murtezaj, Fatime Shala dhe Vlora Kuçi.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të Kuvendit të Komunës së Pejës dt. 26.02.2026.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së KKSBB-së për 2026.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për formimin e komisionit për hartimin e Draft Statutit të Komunës së Pejës.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Drejtorisë së Arsimit Pejë për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zv. Drejtorëve të institucioneve publike edukativo-arsimore në

Komunën e Pejës.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetimit në bashkëfinancim të Komunës së Pejës, Organizatës Islamic Relief Worldwide - Zyra në Kosovë dhe participimi nga qytetaret (fermerët përfitues) në projektin përkrahja e fermerëve në ngritjen e serave dhe furnizim me mekanizëm bujqësor.
8. Rishqyrtimi i Vendimit Nr.01/2026 – mbi themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa - KPF në Komunën e Pejës, në bazë të kërkesës së MAPL për rishqyrtim, me nr. prot: 020-162/5, dt. 13.03.2026.
9. Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimit të anëtarit të N.P.L.”STACIONI I AUTOBUSAVE” SH.A. Pejë.
10. Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimit të anëtarit të N.P.L.”AMBIENTI” SH.A. Pejë.
11. Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimit të anëtarit të N.P.L.”EKO - SIG” SH.A. Pejë.
12. Shqyrtimi dhe miratimi i Nismës për bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar në mes të Komunës së Pejës nga Republika e Kosovës dhe Komunës së Kolobrzeg nga Republika e Polonisë.
13. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit Mbi tejkalimin e planit të hyrave vetanake për vitin 2025 dhe bartjen në vitin 2026.
14. Shqyrtimi dhe miratimi i bartjes së mjeteve të pa shpenzuara buxhetore nga viti 2025, në vitin 2026.
15. Shqyrtimi i informatës mbi procesin e legalizimit të objekteve në Komunën e Pejës.
16. Shqyrtimi i raportit monitorues për zbatimin e qëllimeve dhe objektivave nga PZHK, PU dhe PRR për vitin paraprak.
17. Shqyrtimi i raportit final financiar të Komunës së Pejës për vitin 2025.
18. Shqyrtimi i informatës mbi ndarjen e subvencioneve për vitin paraprak dhe plani për ndarjen e tyre për vitin 2026.
19. Shqyrtimi i informatës së Zyrës për Komunitete mbi procesin e kthimit dhe riatdhesimit për vitin paraprak dhe Planin të Zyrës për Komunitete për 2026.
20. Pyetjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar:
21. Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.

1.Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të kuvendit dhe mungesat.

Nuk ka pasur.

2.Pjesëmarrja publike dhe delegacionet

Nuk ka pasur.

3.Betimi i anëtarëve të Kuvendit, Leotrim Murtezaj, Fatime Shala dhe Vlera Kuçi.

Anëtarët e kuvendit të cilët u betuan pas procedurës së zëvendësimit nga KQZ janë: Leotrim Murtezaj, Fatime Shala dhe Vlera Kuçi.

4.Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të Kuvendit të Komunës së Pejës dt. 26.02.2026.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 33 votë pro, dy anëtar nuk kanë mar pjesë në votim miratohet procesverbali i KK-Pejë dt.26.02.2026.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së KKSB-së për 2026.

Znj.Mubera Belegu: unë kam një pyetje tek draft plani i KKSB-së për vitin 2026, tek ambienti pika e 12 e kam pa dhe me gëzon fakti që më në fund komuna e Pejës ka vendosur me u mar me situatën e qenëve endacakë. Deshta veq me pyet kordinatorin dhe në pika të shkurta me na tregu një elaburim si e keni paraparë këtë situatë për qenët endacak?

Z.Ardit Berisha: mendoj që fillimisht do të ishte mirë që ekzekutivi të na tregoj se pse kryetari nuk është në seancë për shkak se nuk e patem asnjë informacion dhe as nuk kanë lajmëru me e-mail që sot nuk është këtu! Tek shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës mendoj që secili raport ose plan është mirë me u prezantuar prej drejtorëve ose në këtë rast prej nënkrytarit. Së paku të dim se cili është plani, cila është metodologjia e këtij plani dhe me na njoftu pak më shumë si asambleistë të kuvendit komunal para se me hedh në votim.

Znj. Hidajete Nikçi: unë në këtë draft kisha propozu me shtu tek çështja e arsimit, mbikqyrjen e kioskave apo dyqanve të cilat janë në afërsi të shkollave që shesin gjëra ushqimore dhe pije. Po ashtu edhe brenda shkollave të jetë një mbikëqyrje për sigurinë e fëmijëve ose nxënësve tanë.

Kryesuesi Rexhep Kurtbogaj: kryetari nuk është prezent për shkak të një obligimi që ka me qenë pjesë e një paneli, përndryshe kryetari në shumicën e rasteve është prezent në sallë.

Nënkryetari Fatmir Asllani: sa i perket pyetjes për qenët endacak, në vitin e kaluar veç e kemi përfunduar strehimoren. Është vonu shumë akreditimi dhe licencimi i strehimores, sespe ka shku përmes agjencionit të veterines. Mirëpo komuna e ka nda hapsirën dhe i ka kry obligimet se çka është dasht me i kry. Strehimorja gjendet në Sferkë, është licencuar dhe është duke punuar, por po shkon me një ritëm shumë të ngadalshëm edhe pse kërkesat dhe nevojat i dim të gjithë për qenët endacak. Shpresojmë që këtë vit do të kemi sukses sa i perket uljes së numrit të qenëve në qytet. Tek plani i punës tek metodologjia janë në bazë të ligjit dhe janë parapa temat të cilat kanë me u diskutu, i kemi 6 seanca të parapar me i mbajt

brenda vitit kalendarik. Brenda këtyre gjashtë seancave unë si kordinator dy herë raportoj para asamblesë për pikat, temat që janë trajtuar, që janë diskutuar edhe veprimet që janë marrë në lidhjet me temat. Sa i perket trafikave tek shkolla jemi duke u marrë me atë punë, edhe tek videolojrat rreth shkollave, inspektoriat dhe policia e kanë marrë përsiper dhe shpresojmë që do të kemi përgjigje definitive gjatë javes.

Z.Drin Veselaj: pyetja ime është për nënkryetarin në lidhje me trajtimin e qenëve endacak tha që në sferk është një strehimore ne e dimë që kjo ka qenë edhe në të kaluarën, mirëpo me sa e di unë ajo është mbyllurë për shkak që kanë vlerësuar dhe konstatuar që janë keqtrajtuar kafshët aty edhe ka pas domethënë shumë që kanë ngordhur në atë strehimore. A bëhet fjalë për strehimoren e njëjtë? Për njerëz që e menaxhojnë njerëzit e njëjtë apo ka është dikush tjetër edhe ka ndryshuar ai vend? edhe pyetja tjetër është a do të kryhet trajtimi i gjithë këtyre qenëve endacak gjatë këtij viti? Për shkak se kem rastin para një jave një koleg timin midis qytetit ka pas kafshim nga qenet endacak. Prandaj mendoj që është jashtëzakonisht e nevojshme që të trajtohet me prioritet kjo çështje për shkak se ne të gjithë i kemi fëmijët nëpër shkolla dhe vërtetë është një gjendje kaotike në qytet.

Nënkryetari Fatmir Asllani: nuk është e njëjta tash është ambulante atëherë ka qenë strehimore tash është ambulante. Tregova edhe më herët që është licencuar prej agjencionit të veterinars është me standarte. Domethënë çka kanë kërkuar ata është dashur operatori që e ka ndërtuar është ambulante e re e ndërtuar atje, mundeni me shku edhe me vizitu e tash trajtimi bëhet aty janë rregullat qysh janë të parapame, di se buxheti çka është kërkuar me u nda për trajtim është i ndar buxheti tash sa mbërin operator tash nuk e di planin e veprimit në detaje. Po mundemi me pyet edhe menaxherin e kontratës për detaje të tjera! Po e di që ambulanca ndoshta më e mira në Republikën e Kosovës me standartet qysh na kanë referuar edhe agjencionin i veterinars.

Nga të gjithë antarët prezent me 34 votë pro, një antarë nuk ka marr pjesë në votim, miratohet Plani i Punës së KKS-së për 2026.

6.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për formimin e komisionit për hartimin e Draft Statutit të Komunës së Pejës.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: është një pikë që është diskutuar si propozim edhe në komitetin për politikë financa. Fillimisht kryetari me ekzekutivin dhe një komision komunal janë duke u përgatitur materialet paraprake të cilat do t'ju dërgohen këtij komisioni pasi që zgjedhet gjithashtu edhe anëtarëve të kuvendit. Qëllimi apo arsyeja pse domethënë është lehtësimi edhe mundësia për me u kryer punët edhe me u rrit performanca e komunës që të ndahen disa digastere të jenë të veçanta.

Nënkryetari Fatmir Asllani: komuna operon që pothuajse rreth 20 vite me të njëjtat drejtori me pak disa ndryshime të vogla. Tash për shkak të avancimit edhe ndryshimeve të mëdha që po vijnë teknologjisë edhe inovacionit është menduar që të bëhen disa ndryshime në menaxhment. Domethënë përparësia tash është se këtu ndryshim të stafit ose shtim të stafit nuk ka. Është në pyetje vetëm pjesa e menaxhmentit. Është menduar të bëhen disa ndryshime të disa drejtori, të ndahen disa pjesë të menaxhmentit në mënyrë që të jemi sa më efikas në dhënie të shërbimeve. Kjo është ideja. Pastaj grupi punues që do të formohet sot do ta bëjë draftin që do ta prezantojë para asamblesë. Do të delë në diskutim publik dhe unë njoftoj qysh tash që të jeni edhe pjesë e diskutimeve publike kur bëhen këto ndryshime dhe të kontribuojmë të gjithë së bashku që ta bëjmë një menaxhment sa më efikas që qytetarët të marrin shërbime sa më të drejtpërdrejta dhe të eliminohen disa burokraci që veç ekzistojnë me vite nëpër disa drejtori. Kjo është ideja e përgjithshme.

Z.Ardit Berisha: atëherë edhe në komisionin për politikë dhe financave kam parashtruar pyetjen siç e ceku kryesuesi se për çka po doni me u ndryshu statuti i komunës së Pejës edhe sot në Kuvendin komunal të Pejës edhe kryesuesi dhe nënkryetari nuk na treguan se për çka ë dëshiron me u ndryshu ky statut. Njëherë kryesuesi tha digasterët kanë me u rrit dhe kanë me nda nënkryetari po thotë drejtoritë a do të kishte qenë më mirë me thënë jemi ka du me rrit numrin e drejtorive komunale me ja jep një partneri të ri ndoshta të koalicionit apo edhe partnerit aktual mos me na e mbështjellë pak punën. Pra pyetja konkrete është a po doni me i rrit numrin e drejtorive në komunën e Pejës nënkryetar të lutna një përgjigje konkrete? A po dëshironi me rrit numrin e drejtorive dhe sa drejtori po doni me i rrit? Për shkak se me me u ndryshuar ky statut duhet 2/3at e kuvendit komunal, pra duhet edhe votat e opozitës po kërkoj një përgjigje konkrete.

Z.Naim Bytyqi: ndër temat më të ndjeshme të kësaj seance por besoj edhe ma gjerë. Andaj unë konsideroj se nuk duhet me bë shumë politikë, por duhet më konkrete në lidhje me këtë temë në lidhje me çështjen e formimit të komisionit për hartimin e draft statudit të komunës së Pejës. Si shef i grupit asambleistave të AAK-së edhe unë kërkoj të është më e qartë se çka përfshin me detaje ky statut. E di që dikush mund me thënë ju do ta keni një anëtar në komision dhe ai do t'ju njofton. Gjithashtu e di se do të thuhet se do të vjen në dëgjim publik dhe aty do t'i shihni. Pra unë kam përgjegjësi ndaj grupit tim po ashtu dhe ndaj qytetarëve të komunës së Pejës kështu që kërkoj me detaje më të sakta arsyen dhe vlerësim më të saktë se përndryshe po mendoj që mos me dërgu as anëtarin tonë në këtë komision. Sa i përket vetëm drejtorive, unë po mendoj se ndërrimi i statudit bëhet edhe për çështje të tjera ku përfshihet edhe interesi i qytetarëve sa i përket vetëm shtimit të drejtorive edhe unë nuk po e shoh shumë të arsyeshme këtë punë. Në emër të grupit të aleancës kërkoj sqarim me detajet paraprakisht, para se me dërgu anëtarin e komisionit sepse vetëm për shtim të drejtorive kujdo qofshin ato drejtori, kushdo që i përdor ne nuk jemi të gatshëm për ta votuar.

Z.Drin Veselaj: pajtohem me Naimin që tha kjo është ndër çështjet më të rëndësishme jo të kësaj seance, por krejt kësaj legjislature dhe për ndoshta edhe për 10 vitet e ardhshme për shkak se ne e dimë që prej 2008-ës statuti nuk ka ndërru. Ne e dimë që statuti është alfa omega e funksionimit të një komune. Prandaj mendoj që është dashur të bëhen edhe diskutime ndoshta edhe politike për këtë çështje për shkak se nënkryetari tha që po du i rrit drejtoritë me pas efikasitet edhe me i eliminu byokracitë por nuk do të ketë ndryshim të stafit ose rritje të stafit. Kjo nënkupton për mua që vetëm ka me ju ndërruar dikujt ulësja me dalë në një vend tjetër për shkak se është një person që ka me ardhë drejtor aty, mirëpo stafi janë të njëjtë. Në qoftë se ai staf deri në këtë kohë nuk paska pasur mundësi me qenë efikas edhe me i kryer detyrat e veta, pse e ka pas një drejtor, atëherë qysh ka me pas efikasitet i njëjti staf të njëjtit njerëz me i kryer detyrat më efikase në këtë drejtim. Po mendoj që është mirë me qenë korrekt me të gjithë anëtarët e kuvendit edhe me subjektet politike. Cili është qëllimi konkret? Mos rastësisht ju ka mbetur ndonjë person i parahatur nëpër drejtori edhe j'a keni premtuar e tash me çdo kusht duhet me ndërru. Po mendoj në çdo çështje që ka të bëjë me votë të domethënë me 2/3at duhet të bëhen paraprakisht diskutime e mandej të sjellet këtu krijimi i komisionit edhe statuti edhe del dëgjim publik për shkak se ne nuk du me qenë ata që e bllokojmë, mirëpo nuk du me qenë as ata që japim vizë një politike të pushtetit.

Z.Berat Ganiqi: keni ardhur me ide po nuk jeni duke treguar qëllimin edhe planifikimi, po kërkon me votu diçka, me çu në shqyrtim, pa cek se çka po doni me nda, cilat janë ato drejtoritë e reja që kanë u formu duhet me dit se ne jemi asambleista, jemi përfaqësues të qytetarëve dhe nuk mundemi veç me ngrit dorën pa e tregu qëllimin edhe planifikimin. Iden po e hudhni po qëllimi mungon edhe planifikimi, ndoshta ju i dini po ne s'po i dime dhe është mirë me i dit. Këtu sa po e shoh vetëm një ndryshim kanë me u vendos disa njerëz të rinjë në krye atje menaxhment drejtor, po jo dhe staf shtesë, stafi është i njëjti. Ndoshta veç kanë me u ngarku, ndoshta veç kanë me u kriju problem mbas problemit mos e dit as kujt kanë me i shërbyer a kësaj drejtorie apo jo! Nëse ka me u nda drejtoria për rini kulturë edhe sport

mirë me thënë që kjo drejtori ka me nda në tre pjesë. Nëse ka me u nda urbanizmi është mirë me tregu që po ndahet urbanizmi. Unë e di që gjatë rrugës një drejtori ka me shu si është ajo drejtorja e Kadastres për shkak që kalon kompetenca të agjencionit kadastral. Mirëpo është mirë me tregu çka jeni tu planifikuar dhe cili është qëllimi deri në fund. Atëherë ne duhet me dit çka po votojmë. Veç çu dorën, ulu dorën. S'po dimë çka. Cilat janë ato?

Nënkryetari Fatmir Asllani: Unë u mundova në fillim me i sqaruar edhe me qenë sa më konkret. Tash nuk do të ketë shtim stafit për shkak edhe të buxhetit të limituar. Staf komuna ka mjaftueshëm po mundohemi që menaxhmentin ta zgjerojmë. Tash sa kanë me u shtuar drejtoritë edhe sa kanë me u mungu ato as unë nuk mundem me thënë sot. Sigurisht që grupi punues që do të formohet sot këtu do t'i diskutojë ato do të vendoset një draft plan. E thashë edhe më herët që ky edhe nëse punohet prej këtij komisioni ka me ardhë si draft. Ky komision ka me punu rreth draftit të planit që duhet me ardhë me u diskutu edhe këtu ka me dalë edhe në diskutim publik. Ju tregova që ideja është me qenë sa më efikas në shërbime. Kjo është ideja kryesore. Tash digjitalizimi ka avancuar aq shumë sa ju të gjithë e dini dhe është menduar me u bë një drejtori e digjitalizimit. Këto po e di si diskutim që e kemi pasur. Tash kjo pjesa tjetër e ndarjes së drejtorive nuk e kam konkret as unë sot me ju thën juve cilat kanë me u shu ose cilat kanë me u nda. Këtu diskutoni bashkarisht ata anëtarë që sot ju i vendosni në këto komisione. Gjatë planit të punës do të diskutohen sigurisht edhe qëllimet konkrete, por asgjë nuk është jashta asaj që e rëndon buxhetin e komunës se është menduar saktë që nuk ka edhe hapësirë buxhetore me u shtu shumë ose me u mungu pak se ne i kemi kuotat e ndame dhe gjithçka është e planifikuar.

Z.Naim Bytyqi: jemi një situatë të papërshtatshme. Unë mendoj nëse është e mundur me shty këtë pikë të rendit ditës për seancën tjetër është shumë me rëndësi, dhe duhet me shqyrtu pak më mirë se me të vërtetë shtimi i drejtorive unë nuk e shoh se është aq i domosdoshëm në këtë rast. Nëse e marrim një shembull konkret, Republika Popullore e Kinës i ka 1 miliard e 400 milion banorë, e ka një buxhet prej 3.1 trilion dollar edhe i ka 24 ministri. Ja vlen edhe për qeverinë e Beratit, por në këtë rast edhe për komunën e Pejës mendoj se është ngarkesë shumë e madhe dhe e panevojshme.

Z.Berat Ganiqi: nënkryetari tha mos më vet se nuk e di as vetë sa drejtori kanë me qenë! Normal kur keni dasht me kriju këto drejtori ju e keni bërë një planifikim buxhetor. Nëse e keni bërë këtë planifikim buxhetor se vetë e përmende, ti duhesh me dit saktësisht sa drejtori i ke, sepse qaq ta mbulon buxheti. Po e shoh si ide, po jo e menduar mirë s'po e gjykoj qëllimin, sepse qëllimin nuk e di në fund qysh e keni edhe tek shkon. Për këto për digjitalizim me pas drejtori e përkrahim plotësisht, mirëpo nuk po shoh ide sa drejtori janë sepse paraprakisht ish dasht me ulë edhe me planifiku buxhetin. Sa kemi buxhet, për qeqaq drejtori i bëjmë së bashku me drejtoreshën e financave, ju kish tregu sa drejtori mundet me i mbulu edhe kishit thënë tri drejtori, katër drejtori ose sa të tjera kanë me u formu!

Z.Islam Husaj: Statuti i komunës është dokumenti kryesor i një komune, mirëpo ky duhet të jetë një dokument i gjallë, jo gjithmonë me qenë i njëjti. Sa për informim se ndoshta kanë harruar, statuti nuk është aprovuar që 2008n, por në shtator të vitit 2020 është hartuar ky statut. Mirëpo duke marrë parasysh aprovimin e shumë ligjeve për gjashtë vite, aprovimin e dokumenteve të ndryshme që kanë ardhur nga niveli qendror, statuti duhet të përshtatet këtyre ligjeve dhe domosdoshmërisht duhet të ndryshohet atëherë kur shihet se është më tepër dokument pengues se sa zhvillues apo përkrahës. Prandaj është një mendim, është një përshtypje se statuti për me qenë më funksional e për mos me qenë penguesi i punëve në kuvend, atëherë duhet që të plotësohet dhe të ndryshohet. Prandaj duhet të përshtatem edhe nivelit qëndror. Për këtë arsye unë mendoj se është koha dhe është domosdoshmëri që të bën ndryshim plotësimi i këtij statutit, sepse gjatë punës së tij, ne e kemi parë edhe në mandatin e fundit që shumëçka ka qenë

pengesë për funksionimin e kuvendit dhe të drejtorive. Prandaj unë e mbështes këtë iniciativë dhe mendoj se është koha që duhet të bëhet plotësim ndryshimi i këtij statuti.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: Nëse nuk ka dikush tjetër atëherë po kalojmë te propozimet për anëtare të këtij komisioni. Përbërja e komisionit është gjashtë anëtarë nga kuvendi, dy anëtarë nga ekzekutivi, në këtë rast një anëtar është i caktuar nga sektori i kuvendit, një anëtar nga zyra ligjore e kryetarit, pastaj edhe një anëtar nga shoqëria civile.

Anëtarët e propozuar:

Islam Husaj-LDK

Labinot Panxha-AAK

Ardit Berisha-LVV

Edonjeta Berisha- PDK

Muamel Dupljak –BSK

Mirsad Berisha-PLE

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët prezent, miratohet propozimi për formimin e komisionit për hartimin e Draft Statutit të Komunës së Pejës.

7.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Drejtorisë së Arsimit Pejë për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zv. Drejtorëve të institucioneve publike edukativo-arsimore në Komunën e Pejës.

Znj. Hidajete Nikçi: Në lidhje me anëtarët e komisionit, unë nuk kam diçka të shtoj edhe pse kam respekt të veçantë për zonjën Shqipe, mirëpo ne e dimë që kryesisht zgjidhet, drejtori dhe zëvendësdrejtori nga kryetari i komunës. Unë kam një sugjerim që në këto konkurset e ardhshme të mos zgjidhen drejtorë në baza politike, të mos zgjidhen drejtorë të cilët janë të papërgatitur, të mos zgjidhen drejtorë të cilët nuk dinë me udhëheq edhe nuk dinë me menaxhu mirë institucionin arsimor, sepse ne e dimë domethënë që çfarë rëndësie ka institucioni arsimor. Bëj thirrje duke parë nga përvoja e deri tanishme nëpër konkurset për drejtor kanë aplikuar vetëm ai i cili ka pas për me u zgjedh drejtor ose zëvendësdrejtor shkolle dhe dy kundërkandidatë sa për me plotësu kriteret e konkursit. Në konkurset e ardhshme, të bëhet thirrje që të aplikojnë dhe kandidatët meritorë të zgjedhen, sepse përvoja deri tanishme e dini mirë domethënë çka na ka ofruar.

Z.Drin Veselaj: Nuk mund mos me marrë fjalën në këtë pikë për shkak se prej 2013-es sa herë që është zgjedhur ky komisione kam diskutuar në lidhje me këtë dhe fatkeqësisht atë çka e kam diskutuar dhe ka ka dalë në fund. Paraprakisht unë mendoj që ky komision nuk është komision për zgjedhjen e drejtorave dhe zëvendësdrejtorëve, mirëpo është komision e legjitimitimit për përzgjedhjen të kryetarit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorave. Ne e dimë që qysh që tre muaj më herët kur ka filluar me u diskutuar ose kur e kanë dit që po ju përfundojnë mandatet. Unë për shembull kam dëgju nëpër qytet që dy tre shkolla veç dihen kush është drejtor, kush ka me u zgjedh zëvendësdrejtor, kush vjen i ri, ku shkon. Pra, nëse kryetari nuk i premtion ndonjë drejtori ose zëvendësdrejtorit, ai nuk bëhet, pavarësisht kualifikimit edhe pjesëmarrjes në konkurs. Edhe kjo është ajo pse njerëzit nuk aplikojnë, shumë profesionistë të cilët i

njohin fushës së arsimit nuk aplikojnë! Jo pse nuk nuk janë të përgjegjshëm e nuk e kanë aftësitë e të tyre për të menaxhuar një shkollë, mirëpo e dinë paraprakisht se kush do zgjedhet në atë shkollë

Z.Islam Husaj: unë nuk po e kuptoj këto diskutimet paraprake që u bënë, ne sot po bisedojmë për komisionin i cili përbëhet prej tre anëtarëve, dy i cakton kuvendi dhe një është nga ministria. Në të vërtetë ligjërisht janë të përcaktuar njerëzit se kush duhet me qenë në komision, një nga drejtorati i Arsimit dhe tjetri nga këshilli i prindërve dhe nga ministria anëtar i tretë. Dhe sot duhet të bisedojmë për njerëzit e propozuar e meritojnë me qenë anëtarë të këtij komisioni, se kush i zgjedh dhe qysh i zgjedh atëherë është një procedure tjetër dhe është një proces tjetër të cilin ne mundtojmë mbasi të kryhet, mbasi të zgjedhet atëherë i i evidentojmë vërejtjet dhe gabimet që janë bë. Prandaj ne sot vetëm të bisedojmë për këta anëtarë të cilët janë propozuar. A meritojnë me qenë pjesë e këtij komisionit edhe kaq? Nuk kemi të drejtë ne me propozuar dikë prej neve këtu për me i zgjedh ata!

Z.Labinot Panxha: po mirë e tha dr.Islami, a e meritojnë? Unë jam këtu mandatin e dytë edhe e di që janë anëtarë të njëjtë që propozohen në këtë komision. A ka profesionistë të tjerë në drejtoratin e arsimit, pse propozohet vetëm kjo zonja edhe a është kjo më e besueshmja për me kryer ato punë, si qëndron puna me këtë zonjën e kështu me radhë. Besoj shumë që drejtori me qenë se është këtu na jep një arsytim, sepse unë mendoj që ndryshimet janë të nevojshme dhe i kontribuojnë shumë edhe transparencës aty. Po ndoshta edhe atë që tha ajo kolegja nga VV-ja hap rrugën edhe atyre tjerëve që nuk kanë ndoshta librezë që të konkurojnë të bëhen zëvendësdrejtor e drejtor. Mirë kishte me qenë me zgjedh edhe të tjerë me i kontribu arsimit ndoshta pak më mirë e më shumë. Po fatkeqësisht qytetarët ju kanë vendosur juve aty përballë me vendos për fatin e tyre. Shpresoj që këtë me qenë shembull pak më i mirë sesa në mandatet e tjera.

Z.Naser Gega: Po me qenë në atë aspektin më zyrtar qëndroj mbas Islamit. Për me qenë në atë aspektin më popullor po e filloj në një formë tjetër. Drini e tha një shprehje shumë të mirë kur tha qysh kam paraparë më ka dalë. Kush s'të ka dalë në arsim qysh e ke paraparë kurrë hiç. Sikur Drini të del edhe të thotë dhe secili prej jush ka konkuruar filan drejtorin dhe nuk është zgjedhur, mund të bisedojmë. Nëse kishim me dalë me emra konkret, prapë mund të bisedojmë. Problemi është që ky komision e ka për detyrë me udhëheq dhe me i përzgjedh prej gjithë kandidatëve tre individë më të suksesshëm. Ata tre individë pastaj po e sqaroj këtë çështje teknike shkojnë te kryetari dhe ky kryetari ka të drejtë me zgjedh. Komisioni ka obligim anën profesionale zyrtare dhe me i përzgjedh këta tre kandidatë e tutje që shkojnë te përzgjedhja. Edhe te kandidaturat është një problem tjetër për shembull që unë e lypim mësimdhënës të matematikës nuk i ke i lypim i kërkojmë drejtorët e shkollave që të aplikojnë nuk i ke. Arsyeja është shumë më e thjeshtë. Për 30€ diferencë te paga nuk të bëhet dikush drejtor. Është problemi se nuk konkurojnë. Vazhdimisht bëjmë thirrje që të aplikojnë, që të konkurojnë. Nuk ecinë tutje. Mirëpo janë edhe disa kriterë. Nëse nuk e ka trajnimin për udhëheqje, nuk ka mundësi me konkuruar. Do të thotë janë disa faktorë, mirëpo mbi të gjitha është faktori i interesit personal, sepse individët, mësimdhënësit nuk kanë interes të bëhen drejtor. Sa i perket kandidatëve Shqipe Karagjyzi është njohëse e mirë e natyrës së punës, jo pse s'dinë edhe të tjerat dinë dhe at mirëpo është që e procedon më tutje më mirë te kandidati tjetër është që e kemi propozuar Flamur Kaliçani mësimdhënës është në shkollë të 8 marsit nëse LDK-ja voton edhe njëherë më tepër duhet me votuar Vetëvendosja këtë kandidat.Pse e them këtë komision? Se deri më tash tre mandate e kam pas VV-ja kandidatin e vet. Kësaj radhe nuk e di cilës parti është ky. Ju ftoj ta votoni të gjithë. Nuk ka të bëjë ky komision absolut me parti. secili prej jush të ishit në këtë komision. Do ta shihni çfarë problematike ka. Prandaj bashkarisht nëse ka me u ngrit kish me qenë diferenca në paga pak më e mirë, kishim me josh edhe njerëz të tjerë që të konkurues të denjë.

Z.Drin Veselaj: E di çka përmenda dhe çka thashë. Thashë që kryetari i zgjedh drejtorat. Nuk thashë që drejtori i zgjedh drejtorat në asnjë rast. Po është për çudi qysh krejt të LDK-së kanë llogari për 30€ diferencë me u bë drejtor që kjo është ajo e çuditshmja që unë s'po mundem me kuptu! Drejtor, unë jo me emër s'po foli se mandej nuk del fjala ime se nëse e potencoj tash atë emër, ju keni me u çu ndoshta me

zgjedh atë person. Kështu që kur kryhet mund edhe me t'i jap emrat që i di mire, unë mund me t'i thënë ty po kur të kryhet i them publikisht edhe ti çohesh edhe e pranon që qata të njëjtë i kam thënë!

Nga të gjithë anëtarët prezent me 20 votë pro, 7 votë kundër, 1 votë e përmbajtur, 7 anëtar nuk kanë marrë pjesë në votim, miratohet propozimi për formimin e komisionit për hartimin e Draft Statutit të Komunës së Pejës.

8. Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetimit në bashkëfinancim të Komunës së Pejës, Organizatës Islamic Relief Worldwide - Zyra në Kosovë dhe participimi nga qytetarët (fermerët përfitues) në projektin përkrahja e fermerëve në ngritjen e serave dhe furnizim me mekanizëm bujqësor.

Z. Shaban Ramaj: Desha dy fjalë me drejtorin. Qysh bëhet përzgjedhja e fermerëve? Çfarë duhet me pas ata? A duhet me i marrë fermerë që duhet me i marrë mjetet dhe që e meritojnë me i marrë mjetet? A duhet qësi që e kanë librezën e parties të juve? A duhet ai dikush me marrë traktorin që jeton në banesë ose atë tjetrin? A e keni bërë listën përpara ku me ja jep se po i bëjshit edhe këto listat duke e marrë parasysh të kalumen edhe a duhet për shembull me i marrë dikush që jeton në Prishtinë e mos me j'a jep atij që meriton e që i ka bërë sendet me ndirsë të vet. Nëse mbas këtij mandati ty drejtor nëse nuk i ndan mjetet qysh duhet krejt qeta fermer kam me t'i sjellë në zyre.

Z. Ardit Berisha: kjo pikë mendoj që duhet me i kushtu rëndësi të veçantë për shkak se ka shumë pakënaqësi të fermerët e sidomos në Lugun e Baranit lidhur me shpërndarjen e këtyre mjeteve bujqësore. Ka shumë fermer të cilët e meritojnë me përfitu në këto mjete bujqësore e ishalla zbatohet ai kriteri i cili është vendosur që nëse kanë përfituar më herët mos me përfitu tash ose ata që aplikojnë realisht në këtë thirrje me qenë përfitues. Ka rast në Raushiq, Kryshec, ke raste plot në Lugun e Baranit që meritojnë me qenë përfitues dhe nuk përfitojnë. Është mirë me pas dhe një mbikëqyrje pastaj, pasi të ndahen këto mjete se a po i shesin apo po i përdorin apo çka po bëjnë me to. Këto shqetësime i kam marrë prej qytetarëve andaj edhe po i adresoj.

Z. Tahir Shala: Sa i perket pyetjes së Shaban Ramaj, unë problem më të madh si drejtor e kam me gjet fonde. Më së pari në komunë e bëjmë një farë lufte përmes drejtorive. Kur jam ardh drejtor subvencionet kanë qenë 30.000, sivjet e kam ngritur buxhetin gjys milionit subvencionit. Domethënë për katër vjet është një rritje te donatorët çdo vit, për gjys milionit kam përmes donatorëve që siguroj përmes ë formës që unë mendoj që është e mirë edhe që ka pas efekt tepër zgjedhja. Konkretisht organizata në fjalë i ka dy përfaqësues, një e kem si komunë domethënë shumicën e kanë ata edhe vendosin ata, ndersa kur kemi na si komunë është komisioni jonë sa i perket përzgjedhjes. Për 4 vjet kanë përfituar diku rreth afërsisht 800 fermerë që mendoj që si komunë fermerë aktiv i kemi 1300. Në databazë figurojnë 1800 po fermerë aktiv janë 1300 s'ke mundur me i dalë të gjithëve mendoj që për sa e di unë i kemi pas dy ankesa zyrtare për 800 përfitues. Prapë po them është një numër rreth 400 që s'ka mu s'kan mujt me përfitu edhe për atë arsye e kam dyfishuar buxhetin për me mund brenda edhe këtij mandati secili me përfituar. Sa i perket Arditit, facebook-in e kam veç për njoftime zyrtare. Konkretisht për një fermer kishe komentu më së pari duhesh me vet atë sa herë ka përfituar që sa jam unë drejtor tani me ngrit pretendime të tjera. Vetë sa herë ka përfituar i njëjti. S'mundet dikuj 70 herë e dikuj asnjëherë. Janë do kritere s' shkeli për asnjë njeri kurrë s' shkeli asnjë kriter as nuk e shti dikë në komisionin!

Z. Shaban Ramaj: drejtor ne nuk jemi duke jetu në hënë, po këtu në Pejë jemi qytetarë të këtij vendi, i dimë sendet ti fol mirë pak mos të kapin emocionet. Fol më normal se ne njerëz jemi këtu jam duke jetu, 15 telefonata i kam pas para se me ardh këtu nuk po flas pa arsye. Jam kanë katër vjet kryetar i bashkësisë lokale. Asnjë propozim nuk e keni marrë tonin. Keni shpërndarë vend e pa vend unë jam idhëtari i asaj që me ju ndihmu atyre që e meritojnë nuk kam kundër kërrkujt kurrgjë. Edhe mos t'i kisha pas telefonatat para se me ardh këtu, nuk të kisha thonë. Për që e ke rritur buxhetin ti veç mirë paske bo se qytetarët a do me i mbyt a do me ju ndihmu veç po të them kini kujdes se tash e kqyrim kush po përfiton edhe tani ne jemi këtu prap!

Z. Ardit Berisha: në facebook po rrishe edhe ti, përderisa po i sheh ato është mirë me u përgjigj për shkak se facebooki është rrjet social në të cilën edhe diskutohet edhe debatohet. Kisha kërkuar prej teje me qenë pak më korrekt në qasje për shkak se me gisht me qasje ato unë ato s'i kam dert hiç, nëse nëse më njeh pak edhe si familje që qasjen pak më pak më normale si si drejtor. Listen kam me ta bo ku ja jep, je mësuar ndoshta me legjislaturën e kaluar që i ke ndar ato mjete dhe s'ka dalë kërkush me të vet ku ja ke jep, e ti e din ku ja ke jep komplet me librezë të partis. Mos u shit që je këtu neutral se nuk je e komplet përzgjedhjen e ke bë vetë edhe j'a ke jep, j'a ke çuar te dera vetë. Kështu që unë po të kërkoj fermerëve të cilët e meritojnë me ju ndihmu pavarësisht përcaktimit politik, jepje atyre që aplikojnë për herë të parë edhe unë jam për me u zbatua parimi që të përfitojnë ata që s'kanë përfituar asnjëherë.

Z. Tahir Shala: Ardit me dorë bëj kështu në përgjithësi, veç dije që jam shumë i kulturuar, po kur e tepron jam shumë i rrept, po s'kam pas telashe personalisht në jetën time me dike! Sa i perket përzgjedhjes po thua që e kam bë unë vetë, atëherë nëse je i saktë, i sigurtë që unë i kam përzgjedhur, shumë e thjeshtë e ke mundesh me bë një aktuzë edhe unë shkoj dikund tjetër. Por qasje kërcënuese një nuk kam edhe e dyta që nese je aq i sigurtë që unë i kam përzgjedh 100%, unë s'jam pjesë e komisionit lirisht janë organe të tjera që mundem me shku.

Z. Shkumbin Prekaj: Unë veç desha me plotësu drejtoin shkurt në bashkësinë territoriale të Duboves dhe Ozdrim. Gjashtë aplikues kanë qenë në vitin 2025. Pesë prej tyre janë të partive të tjera. Një është i LDK-së, tre janë të VV-së, të AAK-së janë dy. Një është i LDK-së prej gjashtë përfituesve të mjeteve bujqësore.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 28 votë pro, 7 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, miratohet projekti përkrahja e fermerëve në ngritjen e serave dhe furnizim me mekanizëm bujqësor.

9. Rishqyrtimi i Vendimit Nr.01/2026 – mbi themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa - KPF në Komunën e Pejës, në bazë të kërkesës së MAPL për rishqyrtim, me nr. prot: 020-162/5, dt. 13.03.2026.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: vendimin për themelimin e komitetit politik financa nga vlerësimin që kemi marrë nga ministria na kanë kthyer për rishqyrtim. Për faktin që në ditën e formimit të këtij komiteti kemi bërë lëshim për shkak se dispozitat ligjore thonë qartë, pjesëmarrja gjinore është e obligueshme. Domethënë subjektet që kanë përfaqësim gjinor janë LDK-ja, VV-ja dhe PDK-ja, në këtë rast i mbetet AAK-së për me reflektu! Kisha kërkua Labi dhe Naimi të bëjnë ndryshim e antarit.

Z.Labinot Panxha: ju i keni katër anëtarë në atë komitet prej të katërve i keni tre mashkuj dhe një femër. Kështu që mirë është me reflektu ju për faktin që i keni numrin më të madh të anëtarëve, ne mbesim me propozimet në fjalë dhe nuk i ndryshojmë.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: në këtë rast propozova nga subjekti i aleancës, meqënëse nuk kanë përfaqësim gjinor që të plotësohet ky kriter, po e kalojmë po e shtyjmë këtë pikë për seancën tjetër të radhës për shqyrtim. Mirëpo këtë kriter nuk mund ta kalojmë.

10.Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimit të anëtarit të N.P.L.”STACIONI I AUTOBUSAVE” SH.A. Pejë.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: meqënëse disa nga anëtarët e kuvendit kanë dhënë dorheqje dhe janë pjesë e komisioneve që i kemi votuar këtu në seancën e kuvendit, duhet të zëvendësohen me anëtarë të tjerë që të plotësohen këto komisione. Në këtë rast i bie që nga PDK propozohet një emër që të zëvendësohet me anëtarin e Kuvendit Albi Shala

Znj.Edonjeta Berisha: nga partia jonë e propozojmë znj.Fatime Shala.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 22 votë pro, 12 votë kundër, 1 anëtar nuk ka marrë pjesë në votim, miratohet zëvendësimi i anëtarit të N.P.L.”STACIONI I AUTOBUSAVE” SH.A. Pejë.

11.Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimit të anëtarit të N.P.L.”AMBIENTI” SH.A. Pejë.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: Meqënëse ka qenë anëtari i këtij komisioni nga subjekti Partia Demokratike Albi Shala duhet të zëvendësohet me një anëtar tjetër.

Znj.Edonjeta Shala: i propozuari jonë është z.Leotrim Murtezaj.

Z.Drin Veselaj: e potencova dhe herën e kaluar po nuk e pasket përmirësu, prapë e keni gabuar keni shkruar NPL Ambienti, është dashur me bo KRM! Sepse unë për një mend kam hulumtu edhe në regjistrim bizneseve nuk ekziston si ndërmarrje prandaj ndoshta ish dasht veç me ndryshu te pikat e rendit të ditës me bo KRM Ambienti

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: ne me një vendim të kuvendit e kemi pas ndarë ndërmarrjen. Ndërmarrja figuron si ndërmarrje publike lokale.

Z.Agron Nikçi: këtë temë e kam diskutuar me Drinin shumë herë edhe mandatin e kaluar unë jam qenë aksionar në NPL Ambientin. Normal që kuvendi i Pejës nxjerr vendime veç për NPL, jo për KRM. Ne e dimë se ky proces i ndamjes ka filluar në vitin 2010. Ka vazhduar kështu deri në vitin 2021. Unë pasi jam marrë si aksionar kam biseduar për shkak se në ish KRM Ambienti pjesëmarrës në këtë ndërmarrje kanë qenë Deçani, Peja, Klina dhe Istogu. Deçani qysh në atë kohë është nda dhe e ka NPL Higjena. Në këtë moment ata kanë mbetur me konto të ndame në ARBK kanë konto të ndame, njësitë të ndame, punonjës të ndamë, asete të ndame, por nuk është kryer procesi sipas rregulloreve që bëhet shthurje të ndërmarrjeve publike. Unë e kam marrë iniciativë me u taku me aksionarët e Klinës dhe Istogut, jemi bashkuar edhe kemi kërkuar ndihmë nga Pamkosi që të na ndihmojë në dokumentacionin për përpilimin për shthurjen të

ndërmarrjes sipas ligjeve që kërkohet nga Ministria e Financave. Ne i kemi informuar komisionet sipas ekspertave që i kemi angazhuar për ndarje të ndërmarrjes. Kemi bërë një nënshkrim të tre nënkryetarëve të komunave që të gjithë pajtohen që me vazhdu si në NPL Ambienti dhe bordi zgjidhet nga aksionarët e Pejës deri në momentin si të zyrtarizohen dhe të ndahet Klina dhe Istogu. Kemi marrë vendim nga komuna e Deçanit që ne nuk kërkojmë asgjë në këtë ndërmarrje dhe jemi të ndamë dhe nuk kemi aksione në këtë ndërmarrje. Domethënë kemi punuar rreth gjashtë muaj në këtë drejtim derisa i kemi plotësuar të gjitha dokumentacionet sipas rregullores që kërkon Ministria e ekonomisë. Tash unë ju kam dërguar e-mail atyre dikur vitin 2025. U bë gati një vjet që s'kanë kthyer përgjigje që të na japin përgjigje a është çështja administrative apo pse s'po vazhdon që edhe komuna e Klinës edhe komuna e Istogut të vazhdojnë me borde të veta dhe ne të jemi zyrtarisht nëpër që të regjistrohemi në ARBK. Ne hala s'kemi marrë përgjigje. Para dy javë kemi pasur takim me zyrtarët e KMDK-së që për shkak se deponia në Pejë do t'i kalojë KMDK-së dhe do të menaxhohet deponia e re nga KMDK që është domethënë ndërmarrja regjionale e menaxhimit të mbeturinave. Ata na kanë premtuar që do të shkojnë në ministritë e ekonomisë se është edhe interesi i atyre që me u bë shturja dhe të përfundojë njëherë e mirë kjo paqartësi. Kështu që ne tash sot u zgjedh dhe anëtar i ri i komisionit është edhe Atdheja edhe unë. Hapin e parë prapë do ta bëjmë që do të lypim përgjigje në ministritë të ekonomisë se ku ka mbetur procesi dhe pse s'u nda për shkak se të gjitha dokumentacionet janë në rregull. Janë memorandumet e tre kryetarëve të nënshkruar që ne pranojmë. E kemi vendimin nga komuna e Deçanit që ne nuk kërkojmë kurrëgjë më, domethënë gjithçka është duke funksionuar në mënyrë ligjore dhe e qartë. Kështu që besoj që brenda këtij viti do të rregullohet edhe në çështje teknike për shkak se këto tre njësi janë të ndame me konto që është shumë me rëndësi me staf, me asete edhe operojnë të ndame. Thjesht bordi zgjedhet nga NPL ambienti i Pejës. Kjo është në pajtueshmëri edhe me tre komuna të tjera.

Z. Berat Ganiqi: është një vendim i asamblesë ashtu qysh është sqaruar në 2010-en që është nxjerrë me u themeluar NPL Ambienti edhe kurrë kjo dritën jeshile asnjë qeverie nuk e ka marrë dhe s'është miratuar si themelim ndërmarrje të re lokale. Për themelimin e ndërmarrjeve sigurisht duhet që me u votu edhe në qeveri ndërmarrjeve lokale, qysh është rasti i fundit në Fushë Kosovë që para kësaj mbledhe të qeverisë u votua domethënë themelimi i ndërmarrjes së re. Nuk mundesh me çkap prej një KRM-së me bë një ndërmarrje tjetër. Në 2020-en ambienti në mënyrë kundërligjore e ka bërë një statut të cilit ju ka referuar si statut i NPL Ambientit pa e marrë dritën jeshile të qeverisë sepse edhe vetë e the ke dërgu dokumenta në ministri të ekonomisë dhe kjo tregon që akoma nuk ka një dritë jeshile me operu si NPL Ambienti. Është si KRM e regjistruar në vitin 2019 e kanë marrë domethënë licencën prej ministrisë për vitet në vazhdim. As nuk kanë licencë të MMPH-së, tash ministrisë së Mjedisit të Planifikimit Hapësinor. As nuk ka kaluar në votim në qeveri dhe po krijojmë borde të cilat ne ligjorisht nuk i kemi në rregull. Kjo është krejt qëllimi që këto borde me i pasur ligjorisht në rregull, me i kaluar disa procedura, me heq njëherë e mirë problemin. Tash lind, cili është bordi i KRM Ambientit këtu? Kë e kemi zgjedhur? Sepse nëse bëjmë KRM, ne duhet me bë edhe një anëtar të bordit të KRM-së atje me votu asambleja, sepse secila komunë ka të drejtë me pas një anëtar të bordit. Këtu kemi një konfliktë mes KRM-së dhe NPL-së, trajtoheni zgjedheni sepse gjithmonë ka me pas probleme. Nuk mundesh me operuar me dy, ke krijuar xhirollogarinë biznesit përderisa ligjorisht nuk je në rregull.

Kryesusi Rexhep Kurtogaj: Fjala është Leotrim Mytezaj, i propozuar që të zëvendësohet me Albi Shalën.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 20 votë pro, 12 votë kundër, 3 votë të përmbajtur, miratohet zëvendësimi i anëtarit të N.P.L."AMBIENTI" SH.A. Pejës.

12. Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimit të anëtarit të N.P.L. "EKO - SIG" SH.A. Pejë.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: kërkojmë edhe një emër të propozuar nga subjekti për zëvendësimin e anëtarit.

Znj. Edonjeta Berisha: ne propozojmë Nasret Hajrizin

Nga të gjithë anëtarët prezent me 20 votë pro, 14 votë kundër, 1 votë e përmbajtur, miratohet zëvendësimi i anëtarit të N.P.L. "EKO - SIG" SH.A. Pejë

13. Shqyrtimi dhe miratimi i Nismës për bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar në mes të Komunës së Pejës nga Republika e Kosovës dhe Komunës së Kolobrzeg nga Republika e Polonisë.

Nënkryetari Fatmir Asllani: Veç një sqarim të shkurtë rreth procedurave të nismes së binjakëzimit tash mos me nda në përqindje, po shumica e propozimeve që vijnë përmes përfaqësive diplomatike që operojnë në këto shtete. Ne me ju tregu sinqerisht nuk jemi asnjë lidhje diçka rreth kësaj, por ka ardhur si propozim i përfaqësive diplomatike për binjakëzim, kryesisht në shkëmbim të përvojave në vizita edhe pak a shumë përshtatet për shkak të relëfit gjeografik, ndoshta pozicionet gjeografike të këtyre qyteteve kanë një ngjashmëri ose në turizëm ose në disa komuna të tjera që kemi pasur bashkëpunim me Turki. Pastaj ne sot po e marrim si iniciativë një nismë për bashkëpunim. Prapë ajo do të kthehet në kuvend për votim dhe miratim. Kështu që ju ftoj të gjithëve ta votoni këtë nismë.

Z. Drin Veselaj: realisht ne si grup në vazhdimësi i kemi përkrahur këto nisma, mirëpo aq kanë qenë të shumta sa që sot kisha kërkuar, bile a e din komuna me sa komuna jemi binjakëzuar? Edhe cili ka qenë përfitimi i komunës së Pejës pos atij akti që ka gjujt kryetari pushkë një një vend. A ka ndonjë përfitim që e ka pasur komuna e Pejës për qëto binjakëzime? Domethënë ne nuk jemi kundër, mirëpo kish qenë mirë me ditur ne si komunë çka përfitojmë në këtë rast.

Nënkryetari Fatmir Asllani: ku do që shkon mysafir në çdo vend ata të çojnë me i promovu vlerat që i kanë. Tash ne kemi bashkëpunim jashtëzakonisht të mirë me Turqinë. Ku disa drejtorë të shkollave atje kanë marrë disa përvoja të mira prej Turqisë. Edhe studenta, nxënësa kanë kërkuar, kemi dërguar edhe nxënësa edhe ata i kanë pru këtu që kjo është shkëmbimi i përvojave që e thashë. Edhe me Kozencën, Italinë promovim të vlerave kulturore ana e arbëreshëve andej na jeni munduar me u përafuar.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 34 votë pro, 1 votë e përmbajtur, miratohet bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar në mes të Komunës së Pejës nga Republika e Kosovës dhe Komunës së Kolobrzeg nga Republika e Polonisë.

14. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit Mbi tejkalimin e planit të hyrave vetanake për vitin 2025 dhe bartjen në vitin 2026.

Znj. Diellza Berisha: Duke qenë se është hera ime e parë që marr fjalën në këtë legjislaturë, më lejoni fillimisht t'ju shpreh urime të gjithëve edhe një mandat të mbarë e të suksesshëm në shërbim të qytetarëve që përfaqësojmë. Besoj fuqishëm se përgjegjësia që kemi marrë kërkon përkushtim, transparencë dhe vendime të drejta. dhe në këtë drejtim shpreh gatishmërinë time të plotë për bashkëpunim me të gjithë ju gjatë këtij mandati në mënyrë që përmes dialogut punës së përbashkët të arrijmë rezultate konkrete për komunën tonë. Tani po kaloj te pika e rendit të ditës. Planifikimi i buxhetit për vitin 2025 nga të hyrat vetanake ka qenë në shumë prej 5.593.510 euro. Ndërsa realizimi i këtyre të hyrave ka arritur shumë

7.795.979.94 euro. Si rezultat i këtij realizimi kemi një tejkalim të të hyrave vetanake për vitin 2025 në shumë totale prej 2.202.470.40 euro. Ky tejkalim i planit të të hyrave vetanake kryesisht është ardhur nga të hyrat komunale, gjobat në trafik si dhe gjobat nga gjykata. Si drejtori në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për menaxhimin e financave publike, propozojmë që të merret vendimi për rritjen e buxhetit nga të hyrat vetanake të vitit 2025 në shumë prej 2.202.470.40 euro. Si dhe të bëhet shpërndarja e këtyre mjeteve në dy kategori, mallra dhe shërbime dhe shpenzime kapitale. Te pjesa e mallrave shërbimeve në shumë totale prej 233.388 euro si dhe investime kapitale në shumën prej 1.969.082.40 euro, planifikimi urban dhe mjedisin shumë prej 15.000 euro, kultura, rinia dhe sportit shumë prej 100.000€, arsimit parafillor në shumën prej 88.388 euro. Ndërsa në kategorinë e shpenzimeve kapitale në nën programet administratë në projektin ndërtimi i objektit të administratës në hapësirat e ish urbanizmit, infrastrukturë rrugore në projektet ndërtimi i implantit në Jabllanicë të Leshanit, ndërtimi i sheshit prej urës së Zallit deri te ura e re Hajdaragve, ndërtimi i kanalit në lagjen Asllan Qeshme. Projekte të reja ndërtimi i mureve mbrojtëse nga rrëshqitja e dheut në lagjen Kapeshnica dhe Dardania. Rregullimi i kanalizimit në lagjet Vitomericë, Kristal, Qyshkë, Dardani, Raushiq. Ndriçimi në Vitomericë, fshatrat e Podgurit, Lugut Trestenikut, Lugut të Lëshanit, Lugut të Baranit dhe lagjet e qytetit, si dhe blerja e autofshisave me furça rrotulluese përshirjen e rrugëve të qytetit. në nën programin bujqësi ndërtimi i kanaleve të ujitjes në rajonet e Lugut të Baranit, Trestenikut, Leshanit, Podgurit dhe Fushës së Pejës. Në programin shërbimet e shëndetit primar në projektet furnizime pajisje dhe inventar për funksionalizimin e ÇMF-së në fshatin Trastenik, shërbimet rezidenciale. Në projektin Blerja e inventarit për shtëpinë e qëndrimit të përkohshëm. Në programin shërbimet kulturore në projektin Ndërtimi i fushës së tenisit në fshatin Brestovek. Arsim fillor i mesëm i ultë në projektet blerja e kombibusve për shkolla, ndërtimi ishkolles fillore në fshatin Lozhan. Ky tejkalim i realizimit të të hyrave kërkohet të buxhetohet për mbulimin e mungesave të obligimeve të papaguara në vitin paraprak si dhe në projektet e reja të arsyeshme dhe me prioritet për qytetarët tone.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 27 votë pro, 7 votë kundër, 1 anëtar nuk ka marr pjesë në votim, miratohet propozimi Mbi tejkalimin e planit të hyrave vetanake për vitin 2025 dhe bartjen në vitin 2026.

15. Shqyrtimi dhe miratimi i bartjes së mjeteve të pa shpenzuara buxhetore nga viti 2025, në vitin 2026.

Znj. Diellza Berisha: Në përputhje me neni 9 paragrafin 7 të ligjit 08/L-332 për ndarje buxhetore të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2025, mjetet e pashpenzuara nga të hyrat e viteve fiskale 2024-2025 në shumë totale prej 1.671.551.26 euro, si dhe tejkalimi i planit të të hyrave në shumën prej 2.202.470.40 euro bartën në vitin 2026 në shumë totale prej 3.874.021.66. Në kategori të shpenzimeve si në vijim: mallra dhe shërbime në shumë totale prej 233.388 si dhe shpenzime kapitale në shumë totale prej 3.640.633.66. euro Në kategori të mallra shërbime administratë shumën prej 30.000, planifikim urban dhe mjedisi shuma prej 15.000, kulturë, rini dhe sport 100.000 euro, arsim parafillor 88.388 euro. Në kategorit kapitale nën programet administratë në projektet ndërtimi i objektit të administratës në Vitomericë, ndërtimi i objektit të administratës në hapësirat e ish urbanizmit, infrastrukturë rrugore në projektet ujësjellësi për fshatrat e Lugut Baranit, ndërtimi i sheshit hotel Korëz urra e Zallit, ndërtimi i urës së automjeteve Kapeshnisë Qendër, ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave gjelbërruse buzë Lumbardhit dhe në lagjen Asllan Qeshme, ndërtimi i trafos në Çerdhe dhe në shkollën fillore në Vitomericë. Blerja e pajisjeve gjeodezike, ndërtimi i shtëpisë së fshatit në Nabërxhan dhe Radac, ndërtimi i rrugës në zonën industriale në Zahaq, Sferkë dhe Llutogllavë. Ndërtimi i implanteve në Raushiq, Kryshec, Broliq, Trestenik, Baran, Glogjan, Nepole, Nabërxhan, Katundi i ri. Asfaltimi i rrugës Sejnor Gjorrë, ndërtimi i murit të lumit dhe veshja e murit me gurë, ndërtimi i impiantit në Jabllanicë të Leshanit, ndërtimi i kanalit në lagjen Asllan Qeshme, ndërtimi i sheshit prej ujërës së zallit deri te ura e re, ndërtimi i rrugëve në Rekë te Allages, Bellopaq, Shtupeç i Madh, Qafa e Broqit, Dukaiv, Kuqishtë, Koshutan, Bogë, Shkrel. Ndërtimi i rrugëve në Kamenicë, Babiq, Pishtan, Millovac, Poçestë dhe Vragocë. Ndërtimi

i rrugëve Çerdhja pëllumbat e paqes, shëtitorja Buzë Lumbardhit, ndërtimi i mureve mbrojtëse nga rrëshitja e dheut në lagjen Kapeshnica dhe Dardania. Rregullimi i kanalizimit në Vitomericë, Kristal Qyshk, Dardani, ndriçimi në Vitomericë, fshatrat e Podgurit, Lugë të Tërstenikut, Lugë të Leshanit, Lugë të Baranit dhe lagjet të qytetit. Blerja e autoshisave me furça rrotulluese përshirjen e rrugëve në qytet. Bujqësi në projektin ndërtimi i kanaleve të Ujitjes në rajonet e lugut të Baranit, Trestenikut, Leshanit, Podgurit dhe Fushës së Pejës. Planifikim dhe zhvillim ekonomik, ndërtimi i muzeut të bjeshkatarisë afër kishës katolike, shërbimet e shëndetësisë primare në projektin furnizimi me pajisje dhe inventar për funksionalizimin QMF-së në fshatin Trestenik, shërbimet rezidenciale në projektin blerja e inventarit për shtëpinë e qëndrimit të përkohshëm, shërbimet kulturore në projektin ndërtimi i fushës së pestë të tenisit në fshatin Brestovik, arsimit fillor i mesëm i ulët në projektet rindërtimi i shkollave dhe anekseve në Nabërxhan, Lozhan Trestenik Lidhja e Prizrenit, Rami Sadikut, Qyshkë, Zahaq, Nabërxhan dhe rrethojave në Hill Mossi Jabllanicë, blerja e kombibusve për shkolla, ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Lozhan i përket arsyetimit. Këtë kategori të tek mallra shërbime do të plotësohet mungesa e mjeteve në vlerë prej 238, 388 euro për shkak të buxhetit jo të mjaftueshëm për pagesën e obligimeve për shërbimet e mirëmbajtjes së objekteve arsimore dhe angazhimit të stafit me shërbime të veçanta në drejtorinë e kulturës. Ndërsa sa i përket investimeve kapitale, mjetet e barta kanë për qëllim të mbulimit të obligimeve të projekteve të cilat janë në realizim më sipër, mungesë e të cilave është si pasojë e mjeteve nga vendimet gjyqësore si dhe realizimin e projekteve të reja me prioritet për qytetarët.

Z.Naim Bytyqi: e falenderoj edhe drejtoreshën për sqarimin se materiali ke bukur voluminoz. E pata një pyetje për fillim mjetet e pashpenzuara nga të hyrat e vitit fiskal 2024-2025. A mundesh me sqaruar këtu se 2025en po e kuptoj se kanë mujt të hyrat prej gjobave, trafikut e tjerë kanë mundur me hy për shembull muajin dhjetor dhe nuk kanë mujt me u shfrytëzuar. Po në 2024-en është mirë edhe për qytetarët me sqaruar këtë pjesë. Një pyetje tjetër ju si drejtoreshë e re, a ke arritur me bërë një listë të përgjithshme të investimeve kapitale? Për shkak se ka investime çka i shohim këtu që kanë filluar tre vite më parë edhe kosto e tyre në atë kohë ka qenë sigurisht më e ultë diku rreth 30%, për shkak se edhe materiali i punëve në atë kohë ka qenë më e lirë dhe tash mundet me të drejtë me u rrit vlera e koston. Mirëpo ka projekte si prej se jam unë asamblesë dhe mandatin e kaluar janë të papërfunduar. A e ke ti një listë të qartë që ky projekt është parapë dhe vazhdon me u kry me 2 milion euro, sepse ndoshta 10 vitet e fundit janë tu nda mjete për ujësjellëse në Lugu i Bajranit për shembull. Projektet në fillim janë paraparë që ky projekt me u kry me 1 milion mos tu ka bërë 3 milion sot? Është desht me u bë ndoshta 1 milion 300.000 për shkak se materiali po e përsëris edhe njëherë ka mundur me u rrit.. Sepse në vazhdimësi jemi duke i bart mjete për këto projekte. Shumica e tyre janë të domosdoshme, i kam lexuar, e kam parë materialin. vetëm se duhet një listë e qartë me u prezantuar para anëtarëve të asamblesë komunale që ky projekt është paraparë në vitin 2022. Po supozojmë me u investuar për shembull me 1 milion euro është rritur për shkak të investimeve kaq euro edhe në fund po parashihet me përfunduar që kaq. Nuk besoj po jam i qartë sepse ka projekte që kanë trefishuar shumë e fillestare.

Znj.Valbona Gjakova Taraku: këtu në raport theksohet se ka obligime të mbetura të cilat janë mbet papaguar. Ndërkohë kemi pasur edhe mjete të paangazhuara. Kjo tregon që problemi nuk ka qenë mungesa e buxhetit, por mungesa e planifikimit të mirëfilltë ose e menaxhimit efikas të tij. Pyetja konkrete për drejtoreshën është duke e ditur situatën që në muajin shkurt shumë shkolla në Pejë kanë mbetur pa nxemje edhe përderisa kemi pas mjete të paangazhuara. Pse nuk i keni angazhuar në furnizim të shkollave me nxemje kur ata që kanë mësuar janë nxënësit si nga mirëqenia e shëndetit ashtu dhe nga mungesa e mësimit.

Z.Drin Veselaj: gjatë analizës që ja kam bërë, domethënë këtyre bartjes së mjeteve vetëm të dy tre projekte potencohet që janë të reja, mirëpo këtu shkruan për shembull ndërtimi i objektit të komunës që ka me u bë kjo po e dimë që është projekt i ri. Mirëpo ndërtimi i urës, automjeteve të përmbi urë të zallit ajo veç është e ndërtuar. A ka të bëjë me pagesat që janë mbetur pa kryer, pa përfunduar apo ka me u ndërtuar edhe një urë tjetër përmbi, veç këtë sqarim. Gjithashtu e pashë asfaltimin e rrugës Sejnov Gjorë

unë prej vitit 2013 e kam potencuar këtë çështje, mirëpo po e shoh që kjo kjo bartje është 133.000 euro. A i keni bartë këto mjete për me pagu operatorin për punë që i ka kryer deri tash apo është për me vazhdu atë rrugë? Pasi që e dimë që kjo në pafundësi ka shkon kjo farë pune edhe këtë e kam ditur që është qështu, por jo që nuk ka me përfundu kurrë. Gjithashtu për kanalin në lagjen Asllan Qeshme? Domethënë të gjitha këto pyetje që po i bëjmë a bëhet fjalë për ndonjë kanal të ri apo me i kryer pagesat që s'keni mundur me i kryer me operatorin që keni pas kontratë?

Znj. Ilirjana Gafuri: sa i përket kësaj pike u potencia se investimet kapitale do të jenë 3.600.000 euro vetëm këto të dislokum prej vitit të kaluar. E pashë në një sqarim që 93.000€ po ndahen për gjelbrimin e pjesës së Lumbardhit dhe të rrugës Asllan Çeshme, dhe po mendoj se gjelbërimi me u lokalizuar vetëm në këto dy pika është shumë e kufizume. Domethënë prej kësaj shumë të madhe të investimeve kapitali është dashur të ndahet një shumë shumë më e madhe për gjelbërimin e qytetit në tërësi. Gjithashtu pres një përgjigje pse as në planifikim për 2026-en nuk janë ashensorë të cilët janë premtuar për banesat publike në qendrën e qytetit? Pika e tretë ku do të kisha do të isha ndalë është edhe te investimet në shëndetësi. Domethënë edhe bartja edhe planifikimi më duket se është shumë i mangtë. Më shumë prioritet i keni jep investimeve kapitale në infrastrukturë të ndërtesave kurse sa i përket pajisjeve medicinale është e mangtë. Domethënë 40.000 euro barten prapë për inventar, kurse 60.000 euro janë planifikuar për blerjen e aparaturave specifike si është ortopani, autokllavi edhe një gjenerator i oksigjenit. Që është sipas meje domethënë një investim i mangtë dhe këtu duhet me pas kujdes sepse me shumën e planifikuar nuk mund të blehen pajisje medicinale të cilat do t'i shërbenin gjithë kërkesave të të gjitha QMF-ve edhe të ambulancave. Edhe te servisimi po shkon për çdo vit planifikimi me 20.000€ për mirëmbajtje të aparaturave dhe servisim, keq që nuk e kemi drejtorin sot këtu, por një servisim me shumën e tillë domethënë është vetëm me mbet me u lut mos me u prishur ndonjë aparaturë sepse e dimë që shumicën e kohës karrika stomatologjike në shumë qendra të mjekësisë familjare kanë qenë jo funksionale, domethënë nuk janë riparuar dhe nuk kanë mundur me u riparuar. Gjithashtu kisha kërkuar prej drejtorit që të na tregojë edhe si kemi ne servisimin, a ka ndonjë marrëveshje kontraktuale, a i blejmë servisimet prej dikujt? sa paguhen edhe si bëhet kjo? Pasi që e dimë shumë mirë që nuk është vetëm poenta me i bler pajisjet, por ato duhet edhe me i mirëmbajt. Kjo është vërejtja për investimet kapitale, në gjelbërimin e qytetit, te ashensorët në banesat publike edhe te investimet për pajisje medicinale në shëndetësi.

Z. Labinot Panxha: Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, ajo që kam rënë në sy është ndërtimi i trafos në qerdhe dhe shkollën fillore në Vitomericë kodin 20840 në shumën prej 58.558€. Edhe në bartjen e vitit të kaluar, nëse nuk gaboj, janë bartë mjetet për ndërtimin e trafos në shkollën Vaso Pash Shkodrani. Pse është bërë praktikë një gjë e tillë këtu te ky menaxhment? Kur e dimë që KEDS e ka për obligim me sjell infrastrukturën deri te objektet, dhe me e lëshuar rrymën në ato objekte ku kërkohet duhet dhe ku është e nevojshme. Pse duhet ne në vazhdimësi me nda mjete për këtë kompani private e cila i mbledh shpenzimet e qytetarëve, që e shpenzojnë rrymën elektrike e ka pak edhe po i vjedh sipas disa analizave që i kanë bërë disa njerëz. Mos të harrojmë për dijenin e qytetarëve në vitin e kaluar janë ndë 35.000€ për ndërtimin e trafos në Vaso Pash Shkodrani, ndërsa tash po ridestinohen këto mjete, pra po barten në shumën prej 58.558 euro. Unë mendoj që kjo është gabim që po ndodh një gjë e tillë dhe si të tillë nuk duhet me e leju dhe nuk duhet me e mbështet këtë kompani sepse unë e kam lexuar një rregullore të tyre ata e kanë për obligim me çu krejt infrastrukturën deri te objektet ku ka objekte banimi apo objekte të administratave publike apo administratave të arsimore, shëndetësore.

Z. Agron Nikçi: çështjet e investimeve kapitale ne e dimë se prej pandemisë ka qenë shumë problem planifikimi i tyre për shkak të ndryshimit të çmimeve. Domethënë në pandemi e dimë se inflacioni ka qenë mjaft i madh edhe kompanitë që kanë qenë të kontraktuara nga komuna kanë pasur çmime të kontraktuara para pandemisë. Pas pandemisë çmimet kanë shkuar domethënë rreth 30 deri në 40% ku edhe disa kompani janë obliguar që të dorëzohen. Po pastaj edhe një vendim që ka qenë nga qeveria është marrë vendim që ato kompani që dëshirojnë të vazhdojnë punën të subvencionohen apo të marrin 20%.

Pastaj edhe OSHP-ja dhe KRPP-ja kanë jepur mundësitë se këto kompani që duanë të dorëzohen në atë kohë kanë mundur të dorëzohen dhe shpusin kontratën pa penalizim apo marrje të sigurimit të ekzekutimit. Kemi projekte që janë më të mëdhaja që është e pamundshme të përfundojmë brenda një vitit por janë dy vjeçare apo tre vjeçare edhe kemi projekte që janë që mund të përfundojmë brenda vitit. Ne e dimë që kemi kontraktuar qysh në shtator kompani me çmime po e marr shembull konkret 10€ asfaltin. Kurse tash në mars jem asfalti ka shkuar në 15€ për shkak se u rrit nafta nga 1€ o në 1,75. Edhe unë çdo ditë i kam përfaqësuesit të kompanive në zyre për shkak se kontratat i kanë vetëm para vitit të ri kurse ndryshimi tash është dyfish. Kështu që është e pamundur të bëhet planifikimi se si do shkojë inflacioni një vit ose dy vite se mundet me ndodhë edhe kundërta. Tash i kontraktujmë ne këto kontratat e reja me 15€ asfaltin, kurse pas një viti të bie nafta dhe betomeni edhe zhavori edhe të jetë 10€, prapë asfalti tash çfarë duam me bë në këtë rast. Kështu që ne i planifikojmë çmimet ashtu qysh janë aktualisht sot në treg. Ne këto ditë e kemi pasur edhe auditorin e jashtëm, domethënë auditorin e performancës që vetëm dy komuna janë zgjedhur për këtë auditor dhe Ministria e Infrastrukturës unë e kam pas kontakte me ta dhe besoj që jeni dalë shumë mire për shkak se i kemi verifikuar gjithë kontratat nga 2019 deri në 2025n se si kanë qenë çmimet të kontraktuara nga ne dhe kanë dalë se të gjitha janë të kontraktuara sipas çmimeve reale në treg në kohën e caktuar. Rasti konkret si përmendet gjithmonë në asamble është çështja e ujësjellësit të Lugut të Baranit ka filluar në 2012-ën. Hala sot s'u kry. Janë 80 km gyp që janë vendosur. Ajo s'kryhet as për një muaj, as për dy muaj, as për një vjet. Vitin e kaluar ka pasur presione që me u ndalë ai ujësjellës ka filluar procedura penale ndaj meje dhe operatorit e dini krejt e janë bllokuar makinat, janë shkuar tetë muaj në Carabreg atje ju kanë qitur blëmbat kurse dikur muaji nëntor kanë pushuar të gjitha hetimet dhe ne tash jemi detyruar që ta ripërsëritim tenderin për shkak se aty për 400m ka mbet të shkojë gypi në kaptazh dhe të funksionalizohet ai ujësjellës. Kështu që unë ju garantoj që ai ujësjellës do të funksionalizohet dhe do të përfundojë për shkak se të gjithë ata që kanë shkuar me mendje të mira në atë vend e kanë pas se është një qëllim i mirë për t'u shërbyer 18 fshatra për ujë të pijshëm. Edhe bartja projektit të Asllan Qeshmës, po marr shembull, ai është projekt që ju e dini, dy lagje kanë qenë të shkatërruar tërësisht, u bë tre vjet aty kanali është punuar në disa faza. Domethënë është e pamundshme që të punohet brenda vitit komplet kanali për shkak se ka ozopime, ka mbidërtime mbi kanal edhe ne gradualisht po duhet me shku i rrënuar ato mbi ndërtime dhe t'i përfundojmë. Njëkohësisht është fjala për gjelbërimin rreth Lumbardhit dhe në Asllan Qeshme, aty hyn edhe pjesa e shpronësimeve në atë vlerë për shkak se nuk ka kohë të veçantë më për shpronësime duhet të bëhet në kuadër të ndërtimit edhe shpronësimi i atyre pjesëve. Për liftat edhe kjo është një temë e njëjtë. Ne i kemi ndërtuar dy lifta si drejtori, na u ka ndaluar nga ministria për shkak se nuk llogaritet që është investim kapital në hapësirë publike. Llogaritet që është investim në pronë private apo pronë të përbashkët të banuesve. Ne e kemi planifikuar një shumë 150.000€ nëse e kam të saktë për vitin 2027. Po duhet edhe njëherë me u sqaruar mirë se mos të bëjmë shkelje për shkak se ajo po llogaritet si investim jo kapital në hapësira publike, por në hapësira të përbashkëta private të objekteve. Edhe për këtë arsye ka ngeç ky procesi i liftave.

Nënkryetari Fatmir Asllani: Në shkollën Vaso Pash Shkodrani e kemi nisur para nëntë viteve me Ministrinë e Administratës në atë kohë edhe çerdhën në Vitomericë e kemi bërë me investime të Bashkimit European. Për të dy këto objekte jemi kanë me thënë një fjalë kështu të kushtëzuar me bë zgjidhje teknike për rrymë. KEDS nuk na ka dhënë mundësi në me u kyqu në rrjetin ekzistues për shkak të kapaciteteve që i kanë pasur. Të dy këto objekte janë shumë të mëdhaja edhe me aparatura që i kanë dhe ne kemi jemi të obliguar me bë zgjidhje për me i kyq këto dy objekte në rrymë, edhe për ata na u ka imponuar në një farë forme me investu në trafo për me bë zgjidhje teknike dhe me qenë ato objekte funksionale. Vlera e këtyre objekteve është shumë e madhe edhe funksionimi i tyre është shumë efikas dhe ne s'kemi mund e lënë anash këtë punë për dy trafo. Domethënë zgjidhje me qenë këto objekte sa më funksionale na është dash me i ble këto trafo.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 25 votë pro, 3 votë kundër, 2 votë të përmbajtur, 5 anëtar nuk kanë marrë pjesë në votim, miratohet bartja e mjeteve të pa shpenzuara buxhetore nga viti 2025, në vitin 2026.

16. Shqyrtimi i informatës mbi procesin e legalizimit të objekteve në Komunën e Pejës.

Z.Ardit Berisha: fillimisht drejtoresha për financa e bëri një sqarim goxha të mirë të planit të saj dhe punë të saj. Besoj që dhe drejtorë të tjerë duhet me marrë shembull edhe planet edhe raportet e tyre me i prezantuar për anëtarëve të asamblesë komunale. Në këtë rast edhe drejtoresha është mirë që raportet e saj t'i prezantojë për anëtarëve të Kuvendit komunalë qështu edhe në komisionin për politikë dhe financa më duket që ke e papërgatitur, lidhur me këtë çështje, nuk ka ditur me na jep sqarime lidhur me kërkesat për legalizim, sa nuk janë trajtuar, sa kërkesat e qytetarëve janë në pronë shoqërore, sa janë në pronë komunale, sa janë në pronë bujqësore apo të cilët kanë probleme me çertifikatat e pronësisë. Andaj kërkoj prej saj që të na jepë një raport të detajuar lidhur me këto çështje me statistikat e sakta. Për shkak se raportin të cilin ne e kemi pranuar në e-mail prapë mbetet i mangtë, nuk mbetet një raport i një drejtori ashtu e konsideroj unë prandaj kërkoj më shumë profesionalizëm prej saj.

Z.Naim Bytyqi:Unë nuk mendoj që drejtoresha ka qenë jo profesionale se kam qenë në Komitet për Politikë dhe Financa. Mirëpo raporti duhet me qenë pak më më i qartë për neve si anëtarë edhe për të gjithë asamblesët dhe të gjithë qytetarët, po besoj që drejtoresha tash e ka rastin me na sqaru raportin!

Znj.Arta Nallbani: nuk është një raport, është një informatë e procesit të legalizimit për vitin paraprak, pra për vitin 2025. Edhe qëllimi i kësaj informate është informimi i drejtë i qytetarëve të komunës së Pejës me gjithë procesin me të cilin ne po ballafaqohemi si drejtori proces e cila do të thotë zhvillohet në pajtueshmëri të plotë me ligjin për trajtimin e objekteve pa leje, më saktësisht ligjin me numër 04 /L -188. Sa për sqarim fillimisht ndoshta duhet me cek që ky ligj ka skaduar në fund të vitit 2025. Pra me 31 dhjetor afati i tij ka skaduar, mirëpo me një vendim të qeverisë është shty edhe për 12 muaj të tjerë. Pra ne po vazhdojmë me e zbatu këtë ligj edhe për 12 muaj të tjera që i bie më saktësisht deri më 31 dhjetor të vitit 2026. Para se me filluar me informatën, ky ligj është hartuar nga qeveria që i bie gjërisht nga Ministria për Mjedis, Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë dhe është miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Me fjalë të tjera do të thotë ligjdhënësit janë qeveria dhe ministria MMPH, ndërsa zbatuesit e këtij ligji dhe akteve të tjera përcjellëse dhe udhëzimeve të tjera administrative është komuna e Pejës, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit. Edhe njëherë po ta sqaroj, nuk është një raport i detajuar, se nuk më është kërkuar me bërë raport të detajuar, por është një informatë që i informon qytetarët si po ecën procesi i legalizimit, sa kërkesa i kemi pranuar, sa janë shqyrtuar, sa janë regjistruar në regjistrin për regjistrimin dhe janë pajisur me çertifikatën e legalizimit dhe sa të tjera nuk kanë mundur me u legalizu. E kam cek edhe listën e pritjesë ku kam thënë që lista e pritjes përbëhet nga dy pjesë të tjera. Pra përbëhet nga në pjesën e parë të listës së pritjes përfshihen ndërtimet për të cilat është dorëzuar aplikacioni. Mirëpo aplikuesi ose pala që ka bërë aplikacioni nuk e posedon çertifikatën e pronësisë, pra investitori apo pronari i objektit, nuk e posedon pra çertifikatën e pronësisë. Problemi kryesor që ne përballemi janë problemet pronësore që i kanë pothuajse çdo e dyta familje apo çdo i dyti ndërtim që është i ndërtuar pa leje, nuk e posedon dokumentacionin e nevojshëm që dëshmon të drejtën e tij si pronar i ndërtimit pa leje dhe të drejtën pronësore ose të drejtën e shfrytëzimit mbi parcelën ndërtimore, qoftë shtëpi apo banim kolektiv. Ndërtimet që përfshihen në pjesën e parë të listës së pritjes mundën me kohë me dalë nga lista e pritjes dhe të kthehen në shqyrtim kur aplikuesi e siguron edhe na e sjell dokumentacionin e kërkuar, dokumentacionin përkatës. Ndërsa në pjesën e dytë të listës së pritjes përfshihen po ato ndërtime për të cilat është dorëzuar aplikacioni, por ligji e parasheh se ndërtimi përkatës është bërë edhe komuna në bazë të dokumentacionit e konstaton se ai ndërtim është bërë në pronë shoqërore, pronë publike, tokë bujqësore nën komasacion dhe nën sistem të ujitjes, sipërfaqe të mbrojtura, zonë të mbrojtura, zona të veçanta të mbrojtura, zonë të veçantë ose korridor infrastrukturor. Po ashtu komuna është përgjegjëse me i trajtu të gjitha objektet apo ndërtimet pa leje të cilat kanë ardhur dhe janë ndërtuar ose janë pjesërisht të ndërtuara para datës 5 shtator 2018. Ato të cilat nuk janë të ndërtuar dhe ka vazhduar ndërtimi i tyre edhe pas kësaj date kërkesa refuzohet deri në një vendim tjetër ose në një krijim

të programit tjetër nga ministria apo qeveria. Këto ndërtime të cilat përfshihen në listën e pritjes mbesin në listë të pritjes derisa të krijohet thashë një program tjetër prej qeverisë megjesisht prej Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit hapësinor. E kam cek sa kërkesa kanë ardhur gjatë vitit 2025. Kemi pranuar gjithsej 377 kërkesa ku vetëm 152 prej tyre kanë përfunduar dhe janë pajisur pra me çertifikatën e legalizimit. E po ashtu këto kërkesa ne i dërgojmë në drejtorinë për kadastër për regjistrim të mëtejshëm të objekteve të tyre.

Z.Berat Ganiqi: vetë drejtoresha ceki qysh edhe ligji e përcakton deri më 5 shtator 2018 duhen me qenë ndërtimet për me u trajtu si kërkesë. Mirëpo refuzime të kërkesave nuk pamë këtu ndoshta nuk kanë aplikuar ose s'është refuzuar ndonjë kërkesë. Po ashtu çka nuk pamë është edhe ndarja a është ndërtim pa leje, a është ndërtim me leje që është ndërhyer pa leje? Domethënë as këtë ndarje s'është bërë për informatë dhe ne jemi asambleistë edhe normal që kërkojmë sqarime tutje. Edhe a janë të gjitha pëlqimet që janë jep ndërtime para datës 5 shtator të vitit 2018? Këto janë shumë me rëndësi me pa si baza si data edhe pse kundërshtim mundet me bë dikush mbas datës 5 shtator 2018. Po a ka ndonjë ndërtesë që është aprovuar edhe që tash së voni u bë legalizim edhe pse ka filluar ndërtimi shumë më vonë se 5 shtator të vitit 2018?

Z.Labinot Panxha: drejtoresha e ceku që kjo është një informatë në kuadër të kësaj informate qytetarët duhet me u informu pak më detajisht. Pra komuna ka lejuar me u ndërtu deri në vitin 2018 qytetarët e pandërgjegjshëm me bë ndërtime pa leje. Domethënë me pas të qartë qytetarët qëtu. Tash kush ka ndërtuar deri në vitin 2018 pa leje, ka me i legalizuar edhe me i plotësuar ato kriteret që tha drejtoresha! Mirëpo unë e kam edhe një pyetje shtesë qytetarët duhet me u informuar sikurse duhet me informuar edhe ne se nga viti 2018 e deri më sot, sa ka ndërtime pa leje, dhe çfarë hapash janë ndërmarrë në parandalimin e ndërtimeve pa leje. A po zbatohet plani rregullues apo i përmbahen atij plani qytetarët? A ka inspektorë që inspektojnë dhe a bëjnë raporte ata inspektorë kur shkojnë dhe i shohin që dikush po ndërton pa leje dhe a ka ndërmarrë ndonjë veprim komuna tek ata qytetarë të pandërgjegjshëm që ndërtojnë pa leje. Po mendoj që ish dashur edhe ne si asamble por edhe qytetarët me u informu rreth kësaj çështje.

Znj.Arta Nallbani: po filloj me pyetjet e z.Ganiqi. Po e pashë në raport përgatitur nga zyrtarët e drejtorisë sonë nuk pashë refuzime dhe nuk ka refuzime në regjistrin tonë për arsye që thashë presim dokumentacionin ata me e plotësu dhe mbesin në listën e pritjes ashtu qysh e parasheh ligji. Ndërsa sa i përket pyetjes tjetër se a ka të legalizuar ndonjë objekt që është ndërtuar ose ka filluar ndërtimin pas datës 5 shtator të vitit 2018 me dijen time nuk ka, edhe nuk është legalizuar se nuk ne nuk kemi të drejtë me bë diçka çka nuk e e parasheh ligji edhe çka nuk nuk shkruhet qartë që mundet komuna gjësisht drejtoria me bë! Unë të sugjeroj ty edhe të të nxis me bë një kërkesë zyrtare tek personi i përgjegjës që ofron qasjen dokumente zyrtare me emër mbiemër të atij të cilët ti po pretendon që e kemi legalizuar, edhe në një afat sa më të shkurt kohor zyrtarët edhe unë vetë përgjigjja edhe të ofroj dokumentet e nevojshme zyrtare. Ndërsa sa i përket Labinotit unë po besoj që çështja e inspektimit është një temë tjetër e që nuk lidhet me mua. Drejtoria e urbanizimit është kompetente me bo lëshimin e lejeve të ndërtimit në kuadër të planeve rregulluese që i posedon e që tash po e shfrytëzoj rastin me i cek edhe pse për shumicën veçse e dimë që komuna e Pejës e ka të miratuar plani zhvillimor komunal nga viti 2020 deri në vitin 2028, dhe hartën zonale të komunës së Pejës nga viti 2023 deri në vitin 2031 e që komuna e Pejës saktësisht drejtoria jonë operon në pajtueshmëri të plotë me legjislacionet aktet nënligjore dhe udhëzimet administrative që dalin nga këto plane rregulluese. Sa i përket inspektimit të këtyre ndërtimeve prej kësaj periudhe deri me ditën e sotme është Drejtoria për punë inspektuese që merret dhe i ka inspektorët përkatës që merren me këtë punë.

17.Shqyrtimi i raportit monitorues për zbatimin e qëllimeve dhe objektivave nga PZHK, PU dhe PRR për vitin paraprak.

Znj.Arta Nallbani: meqënëse dhe kjo është një informatë për shqyrtimin e raportit monitorues për zbatimin e qëllimeve dhe objektivave që kanë dalë nga plani zhvillimor komunal dhe planet rregulluese për vitin 2025. Unë më herët veç e ceka që komuna në drejtorinë për urbanizëm kemi PZK-në apo planin zhvillimor komunal të miratuar me datë 27 dhjetor 2019 si dhe hartën zonale të komunës së Pejës të miratuar më 28 dhjetor vitin 2023. Sa për sqarim këto janë objektet këto janë është raport monitorues për zbatimin e qëllimeve dhe objektivave të cilat kanë dalur jo vetëm nga drejtoria jonë pra janë të gjitha projektet që kanë dalë duke e përfshi zyrën e kryetarit por edhe në bashkëpunim me gjithë drejtor e tjera janë projekte që janë paraparë dhe sa janë përmbushur ose sa janë në proces ose sa kanë përfunduar këto projekte e kemi paraqitur me legjendë pra të gjitha veprimet që janë me prioritet të lartë, të mesëm, të ulët apo ato të tjera të cilat nuk kanë filluar hiç!

18.Shqyrtimi i raportit final financiar të Komunës së Pejës për vitin 2025.

Znj.Diellza Berisha: Sa i përket raportit final financiar për komunën e Pejës për vitin 2025 në cilësinë e drejtoreshës dua vetëm të theksoj se pasqyrat financiare nuk kanë thjesht dokumente teknike, po janë pasqyra reale të mënyrës se si po qeverisim dhe sa me përgjegjësi po i trajtojmë paratë e qytetarëve tanë. Çdo shifër në këto pasqyra përfaqëson një vendim, një prioritet dhe një përgjegjësi ndaj qytetarëve tanë. Prandaj menaxhimi i buxhetit nuk është formalitet, por një proces i bazuar në transparencë, llogaridhënie dhe drejtësi. Sa i përket buxhetit të vitit 2025, buxheti total arrin vlerën 43,102,061.36 euro. Këtë buxhet mjetet e grantit qeveritare përbëjnë 82.63%. Të hyrat vetanake marrin pjesë me 12.98%. Të hyrat e bartura nga viti 2024 3.30%. Donacionet në buxhet marrin pjesë me 0.23%. Pjesa më e madhe e këtij buxheti i takon kategorisë paga dhe medijtje që kapin vlerën 20,191,890.89 euro që kjo kategori përfshin 49.20%, mallra dhe shërbime 13%, shpenzime komunale 2.54%, pagesa dhe transfere dhe subvencione 3.07%, ndërsa investime kapitale 32.18% 18%. Sa i përket të hyrave e diskutuam që kemi një tejkalim të hyrave planifikimi ka qenë 5,593,510 euro ndërsa të hyrat e gjithëmbarsuem në fund të periudhës raportuese arrijnë shumën 8,037,289.96 euro Domethënë në krahasim me periudhën raportuese të vitit paraprak kemi një janë më të larta për 6.81%.Teek këto të hyra pjesën më të madhe e marrin tatimin në pronë 38.80%.Të hyrat nga taksat komunale për leje të ndërtimit 26%, gjobat, taksat e regjistrimit të automjeteve 4.80% si dhe të hyrat nga taksa për ndërim dhe destinim të pronës 7.60%. Duke qenë se ky raport është i karakterit informativ dhe raportet të tilla financiare për vitin 2025 i kemi diskutuar edhe në seancën e kaluar.

Znj.Valbona Gjakova Taraku: Tek buxheti final edhe ai i realizuar ka një diferencë tek të hyrat tatimore dhe jo tatimore. Te të hyrat tatimore kemi mungesë prej 753.000 euro. Ndërkaq ato tatimore 1,722.00€. euro. Kjo tregon se ose ka pas mungesë planifikimit ose ka qenë planifikim jo realist ose keni dështuar në inkasim. Cilat janë arsytet e këtyre devijimeve dhe kush e mban këtë përgjegjësi?

Znj.Diellza Berisha: Sa i përket tatimit në pronë, e kemi kaluar si pikë në seancën e kaluar tatimin në pronë, pragun për tatim prone e ka caktuar ministria, kështu që nuk është kjo që varet prej komunës së Pejës. Tatim të njëjtë kemi edhe komplet vitin e kaluar edhe po vazhdon sivjet, edhe pse kemi pritur që në 2026- en ka me hy në fuqi ajo që veç e kanë marrë vendim ministria. Ndërsa sa i përket inkasimit, çështja e inkasimit nuk është temë ndoshta që mundet me u diskutu për shkak nuk kemi kushtëzime që ju japim qytetarëve. Në momentin kur kanë pasur kushtëzime atëherë çështja e inkasimit ka shkuar ndryshe. Kështu që nuk është që mundem me ndiku përveç me video ose me çështje sensibilizuese. Nuk është që mundem me ndiku drejtpërdrejt ndryshe.

19. Shqyrtimi i informatës mbi ndarjen e subvencioneve për vitin paraprak dhe plani për ndarjen e tyre për vitin 2026.

Znj. Valbona Gjakova Taraku: te kjo pikë duke i par kriteret të cilat janë përcaktuar për aplikues për subvencionet të bujqësisë. Në asnjë kriter nuk e pashë që i jepet përparësi grave duke e ditur që është përqindje e vogël në nivel të Kosovës dikur rreth 5% përfituese janë ngra. Pyetja ime për drejtorin është duke e ditur për peripetit në cilat kalojnë grate fermere ka të shumta që punojnë çdo ditë në bujqësi, mirëpo ne e dimë se pronat nuk janë në emra tyre kjo mundet me qenë një pengesë për aplikim. Mirëpo çka bërë drejtorja e bujqësisë për me i stimulu gratë për me apliku edhe a kanë marrë masa mbështetëse për me ndihmu ato me aplikuar me i informu.

Z. Tahir Shala: në bazë legjislationit në fuqi ne e kemi një rregullore komunale për ndarjen e subvencioneve që është e miratuar në kuvend që derivon prej një ligji të buxhetit, aty nuk parasheh që diskriminim pozitiv. Sigurisht të jesh e bindur që të regjistruar te ne janë 50 -50 me numër të Nifit referent që e kemi ne në sistem. Ajo çka kemi bë ne është që me tre organizata që kemi pas bashkëpunim i kemi shtyer edhe janë përfitues 100% vetëm gra fermere mundesh me pas listen.

Znj. Ilirjana Gafuri: në lidhje me shqyrtimin e raportit të subvencionimit nga Drejtorja për mirëqenie sociale e cila pra në bazë të ligjeve funksionon dhe përmes kësaj drejtorie përfitojnë organizatat OJQ-të, subvencionim të cilat janë paraqitur edhe me shuma. Ne jemi për subvencionim shpresojmë që buxheti i komunës të rritet ende më shumë dhe këto subvencionime të rriten më shumë pasi që jemi për blerjen e shërbimeve sociale prej tyre. Por kemi vërejtje për gjendjen e tanishme dhe raportimin e të dhënave faktike të cilat duhet të plotësohen në tërësi dhe të informohemi edhe ne si legjislaturë pasi që ju si ekzekutiv po besoj e dini por edhe qytetarët pasi që për ta blehen këto shërbime. Fjala për shpenzimet të cilat i bëjnë këto OJQ-të duke filluar prej pagesës së rrymës, ujit, telefonit, derivateve dhe shpenzimet e derivateve qoftë edhe druve për nxemje të cilat i paguan komuna. Por asnjëherë nuk paraqiten në raport se domethënë janë pjesë të cilat subvencionohen dhe paguhen nga buxheti i komunës. Propozimi jonë që ndoshta është shumë më mirë që pagesat e këtyre të bëhen nga vetë këto organizata dhe të llogariten në planifikim në kuadër të subvencionit. Domethënë mos të bëhen shpenzime të ndara dhe nuk është me rëndësi sa është ai shpenzim, por ndoshta shumë më mirë është që ato shpenzime të raportohen, të dihet që edhe ato i paguan komuna nga buxheti. Vërejtja tjetër është te auditimi. Unë po besoj se e meriton, faktikisht e kisha justifikim edhe rritjen e buxhetimit edhe subvencionimit edhe më tutje nëse kish me pas një auditim, një trupë auditorit e cila kish me u pagu. Sepse e pamë edhe rastin te drejtori i arsimit që tha domethënë pagesa është stimulim për kryerjen e një pune të auditimit e cila është përgjegjësi të auditohet domethënë si po menaxhohet, si po rrjedh paraja publike në këto organizata. Ky pra auditim do të përforconte dhe justifikonte edhe për rritjet e mëtejshme të cilat duhet të ndodhin. Krejt kjo në drejtim të transparencës edhe sigurisë këtyre shërbimeve që po i përfitojmë prej këtyre organizatave. Vërejtja e tretë është një pikë e dobët e kategorisë së fëmijëve pa prindër e cila siç është parë është pikë e dobët për krejt shtetin, jo veç për komunën tonë. Mirëpo ndarja buxhetore që është bërë për këtë kategori nuk jap ndonjë shpresë që do të kemi strehimore familjare në formën e foster home, të cilat pra duhen të kenë përkrahje maksimale materiale dhe lobim e angazhim për gjetjen e interesit të këtyre familjeve që të merren me këta fëmijë. Po besoj edhe po uroj që vërejtjet që e kemi përmendur do të merren si këshilla dhe interes pozitiv bazuar në rolin edhe që e kemi juridikisht si këshilltar të ekzekutivit.

20. Shqyrtimi i informatës së Zyrës për Komunitete mbi procesin e kthimit dhe riatdhesimit për vitin paraprak dhe Plani të Zyrës për Komunitete për 2026.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: materialin e keni marrë për këtë pikë të rendit të dites, e hapim diskutimin, nese nuk ka diçka atëhere kalojmë tek pika tjeter.

21. Pyetjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç jan pranuar:

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: gjatë ketij muaji Ardit Berisha ka dërguar email. Ka dërguar kërkesa në 4 drejtori në drejtorinë e arsimit, shëndetësisë, shërbimeve publike dhe drejtorisë së kultures. Në këtë rast kërkesat që i ka pasur Arditi i kemi përcjellë te drejtoritë përkatëse. E kanë një afat prej 30 ditësh për me ju përgjigj në kërkesën që e ke në lidhje me çështjen që ke kërkuar me tu përgjigj. Pastaj nëse drejtoritë nuk përgjigjen atëherë te seanca e radhës te çështjet e ngritura e ke mundësinë me i ngrit të gjitha këto çështje ,nëse nuk e merr përgjigjen që ke kërkuar.

22. Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.

Z. Shaban Ramaj: U folen shumë sende qëtu edhe diqysh prapë du me dalë te prioritetet drejtor pare që të thashë edhe po du me vazhdu një farë teme tjetër. Për shembull unë vij prej fshatit Radac ku s'kem ujë të pijes edhe boron drin i bardhë aty. Sa i përket zonës, që është zonë turistike, është kanal, domethënë veç se e ka qit një pushtet më heret nuk na kanë ndihmu me u lidh. E pashë që kishit shti do kanali do përroje në buxhet po nuk e kam pa projin e Jabllanicës Vogël edhe prej Jabllanices së Madhe që bjen në Radavc as aty s'pash diçka që kishit potencu. E pava çështjen tjetër meqenëse zonë turistike ju kisha lutur kryetari me juve stafin i keni shpenzimet prej meje të hekne, veç kryjeni një orar të punës aty, kqyrne sa njeri vjen edhe s'keni bo kurrjë në atë vend. Veç çdo kocka të kuqe i keni shtruar as kontiniera s'keni pru. Domethënë keni bërë hajgare në atë lokalitet. E pava atë rrugë të bjeshkes e keni shtru 3km rrugën e Jabllanices vogël veç për me i marrë do vota! E pava që gjashtë vjet rruga kryesore Jabllanicës e Madhe - Radavc është e prishë Unë e di se keni shti një gyp për ujësjellës për kanalizim. Po asfalti është i prishë gjashtë vjet aty me shku tash me marrë statistikak në polici të Kosovës, veç kqyr sa aksidenti, rruga është shumë e ngusht edhe njerëzit janë takuar ndër vete me kerre. Po ja gjuni topin qeverisë se qeveria se ne s'kemi të drejtë, hajde veç mshelni këto gropa s'po du kurrjë më shumë se janë gjashtë vjet jo gjashtë ditë. Kur të kqyrim këtë periudhën kohore 12 vjeçare për shembull te bujqësia po du me ndal edhe pak janë bronat e Jabllanices së Madhe që janë mjerim, o drejtor hajde bashkë shkojmë t'i kqyrim. As s'po du me fol poletikisht, as s'po ja kam inat kerkujtë, po veç me kryer punë qytetarëve qaty. Ato veç kur në vitet 70-ta kur i kanë ka nevojë shumë për investim, bronat janë kry të katunit. Dy fshatrat qaty e kanë rrezikun më të madhin prej aty, prej atij proit. Ai u rrit shumë rrallë veç kur u rrit ka bë dëmë të mëdhaja, s'e keni shti as atë në program për me lidh me Dri të Bardhë atje. Unë jam i lidhur me qytetarët edhe për këtë arsye dhe i kam marrë votat, se di krejt hallin gjith secill shtëpi për shtëpi edhe për këtë periudhën 13 vjeçare domethënë ju bashkë kurrjë s'keni bë në atë vend. Prap po ju lus hajdeni kryjeni një orar të punës prej tetëve në katër. Tashti kur t'ia nis sezona e nxënësave që vijnë me vizitu kur të vijnë nga 100 autobusa nuk kanë kushte, aty s'ka më ndriçim hiç. Te ambienti ju kasha lut prej këtij momenti me i punësu bile në sezon në dy tre punëtorë me mbajt më pastër, me i pru kontinjerat qysh duhet edhe me ardhë me qenë më të kujdesshëm në atë pjesë. Se ne po përfaqësohem nuk ështëveç unë që jam i Radavcit. Unë e kisha lut kryetarin edhe pres me ardhë me j'a kallëzu gjendjen krejt me shpenzimet të mia keni, veç me pa një ditë keni me ndejt tetë deri në katër se nuk janë ata qytetarët e dorës së dytë Çështja tjetër nënkryetar cila ka qenë arsyeja pse o mshel çerdhja në Vitomericë? A ka qenë kjo puna rrymës a diçka tjetër? Se edhe aty e keni qelë para fushate i keni shti do njerëzit me kontrata mbi vepër mos doni me bo kontratat e rregullta cila është arsyeja që o mshel që e përmendi Labi ?

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: Shaban mundem me qënë krejt ato kërkesat tuaja të arsyeshme. Po qëllimi yt ke për probleme që i ke edhe në rregull. Po në rastin tjetër është një çështje që duhet me ngrit që është për me u diskutu.

Z. Shaban Ramaj: unë i ngrita këto çështje se i keni lënë me u grumbullu me pa kry punë nuk ju kisha thonë. s'po lypi kurr gjë veq një send te ujt e pijes është kjo është shqetësim qysh në shekullin 21 s'kemi ujë të pijes në Jabllanicë të Madhe janë prish pumpat as plus as minus ai model është prej 2012-es, kur i ka pru Ali Berisha ato pumpa nuk i ka ndreq kush! Ju keni premtuar qytetarëve aty në fushatë edhe po vini shpesh po folni ne s'kemi ujë të pijes kjo çështje është prioritet

Nënkryetari Fatmir Asllani: problemin në Vitomericë siç e thashë më herët pikërisht ka qënë çështja te rryma të shtunën është aktivizuar trafo edhe është në rregullë. Sa i përket çështjes së ujit bën nëse s ke ditur po të tregoj veç investon në rrjet kanalizimit dhe kalon pronësitë e hidrodrinit ata janë përgjegjës edhe për mirëmbajtje të pompave edhe për ato mirëmbajtjen e rrjetit, komuna investon njëherë si zakonisht në rrjedh të ujësjellësit edhe pastaj kalon në pronësi të hidrodrinit. Te çështja e kanalizimit atje në pjesën e Podgurit ka kanë një projekt para katër viteve që ka filluar. Ky projekt nuk është finalizuar operatori është i obliguar me i kthy rrugë në gjendje të mëparshme. Sa e di unë që i kemi bërë shkresë operatorit me ardhë me i rregulluar ato, por edhe ajo është arsyetuar që është ndërprer kontrata dhe nuk ka vazhdu. Tash mbetet me qyrr deri ku është problemi i kësaj. Komuna ka problem shumë janë 78 fshatra nuk është veç Podguri, Jabllanica e Radavsi po bajagi shumë fshatra ka, ne i marrim prioritetet që i kemi në diskutime publike edhe i kqyrim! Tash jemi duke punuar në kanalin jugor andej që i furnizon katër fshatrat me ujë kemi nda shumë të konsiderueshme të buxhetit për rehabilitimin e atij kanali edhe po shpresoj që sivjet kryhet ai kanall vazhdojmë me pjesën tjetër të kanaleve. Po ne gjithmonë mundohemi që këtë buxhet çka është me e shpërndar për këto 78 fshatra edhe për pjesën e investimeve në bujqësi. Po tash këtu ka probleme që janë grumbulluar me kohë, me vite edhe mundohemi me ju dhënë prioritet disa disave çka janë më të nevojshme dhe më urgjente.

Z. Labinot Panxha: meqënëse Shabanit j' a paraqite një vërejtje tek çështjet e ngritura, unë po ta kujtoj që ne si anëtarë të kuvendit e kemi kohën e caktuar se sa kemi me fol këtu, dhe sa çështje mundem me ngrit brenda qasaj kohe. E përcakton rregullorja për punët e kuvendit. Një çështje që është shumë me rëndësi e të cilën po ja përcjell në emër të banorëve të fshatit Kosuriq është emërtimi i rrugëve në atë vend. Në të gjitha fshatrat e Lugut të Baranit janë të emërtuara rrugët përveç në fshatin Kosuriq. Në fshatin Kosuriq janë emërtuar rrugët, nuk e di unë se kush i ka lënë ato emra të ish sistemit kur në fshatin Kosuriq të gjithë e dimë që janë 22 të vrarë dëshmorë e martirë në luftën e fundit. Nënkryetar, meqënëse je edhe kompetent kërkoj nga ti që të inicohet kjo çështje, të formohet komisioni, sepse ne të gjithë e dimë që emërimi dhe riemërimi i rrugëve bëhet çdo pesë vite dhe po besoj që kanë kaluar pesë vite prej kur ka qënë në funksion ai komision. Të formohet komisioni dhe të bëhet emërimi i rrugëve në atë fshat, por edhe në fshatrat e tjera ku ka mungesë të emërtimit të rrugëve në gjithë komunën e Pejës.

Nënkryetari Fatmir Asllani: Po Labi ki të drejtë për këtë pjesë në këtë vit veç ka kaluar ai 10 vjeçari që është një afat ligjor se s'kemi të drejtë me i prek. Gjatë këtij viti pothuajse jemi të obliguar ta formojmë një komision për emërtime të rrugëve të reja që janë themeluar me kohë. Po tash te riemertimi është problemi tjetër. Tash nëse hymë ndërime qysh kemi pasur herën e kalume dhe komisioni i atëhershëm na ka devijuar kërkesat e qytetarëve, fatkeqësisht dhe na ka zgjuar disa probleme që pasojat janë edhe sot. Tash ne duhem me mendu mire kur e formojmë këtë komision a duam me formu një komision për emërtimin e rrugëve të reja apo riemertim. Këtu duhet me u bë diskutimi në asamble kur vjen kjo si pikë e rendit të ditës. Po këtë vit jemi të obliguar me formuar një komision për emërtimet e rrugëve të reja dhe këtu duhet me ardhë dhe me u e trajtu dhe me u diskutu.

Znj. Ilirjana Gafuri: unë kam një çështje për të ngritur drejtuar drejtorit të shëndetësisë. Pyetja lidhet me asgjësimin e mbetjeve medicinale. Me vite të tëra ky drejtorat nuk ka bërë kontratë me spitalin i cili është i licencuar për asgjësimin e mbetjeve medicinale. Në rajon këtë mundësi e ka vetëm edhe spitali i Gjakovës. Nuk e di a kanë me ata kontratë, por kisha kërku që të na raportojë drejtori ku është ajo deponi dhe ku mbahen këto mbetje medicinale, të cilat janë të rrezikshme dhe ato duhen me ligj që të asgjësohen.

Z. Ardit Berisha: në këtë pikë të rendit të ditës dua ta shtroj çështjen e mbeturinave në qytetin tonë, ku pas disa jave vizita në terren në lagjet dhe fshat e qytetit, kam konstatuar se gjendja e papastërtisë në qytetin tonë vërtetë është e keqe dhe kjo për mua është e papranueshme. Çështja e deponive legale në komunën e Pejës nuk është vetëm problem estetik, është problem i shëndetit publik, i mbrojtjes së ambientit dhe i përgjegjësisë institucionale. Sot në territorin e komunës së Pejës unë personalisht si asamblistë i këtij qyteti kam evidentuar mbi 25 lokacione me deponi ilegale përgjatë rrugëve në zonat e gjelbërta, në pyje dhe madje pranë lumit. Në këto hapësira gjenden mbeturina shtëpiake, plastikë, materiale ndërtimore, mobilje dhe inerte që degradojnë tokën, ndotin ujërat dhe rrezikojnë komunitetin. Kjo situat nuk është krijuar brenda natës, është rezultat i mungesës së kontrollit, mungesës së monitorimit dhe mungesës së një sistemi të qartë e funksional të menaxhimit të mbeturinave. Një problem serioz që duhet adresuar është mungesa e informimit të qartë dhe transparent për qytetarët. Ku mund të hidhen mbeturinat inerte? Cilat janë lokacionet e autorizuara nëse ka? Cilat janë kostot për deponimin e mbetjeve ndërtimore? A ekziston një tarifë zyrtare dhe ku është e publikuar? Kur qytetarët nuk kanë informim të saktë për opsionet ligjore dhe për kostot përkatëse krijohet tërën për hedhje ilegale. Nga kryetari i komunës dhe drejtori për shërbime publike, kërkoj një plan të qartë për pastrimin e të gjitha deponimeve ilegale në komunën e Pejës në afat të përcaktuar kohor. Publikim transparent të lokacioneve të autorizuara për hedhjen e mbetjeve inerte, publikim të qartë të tarifave dhe procedurave, vendosjen e tabelave informuese në terren, masa parandaluese si monitorimin, inspektimet sistematike, gjoba efektive dhe vendosjet e kamerave në lokacione të caktuara. Po ashtu kërkoj sqarim të plotë lidhur me rastin e dokumentuar ku një kamionetë e ndërmarjes komunale Ekosig është kapur duke hedhur mbeturina në lokacionin të Borea përveç kërkesës dhe detyrimit nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor. A ka pasur masa për menaxhmentin apo bonësit e caktuar? Nëse institucionet nuk japin shembull, nuk mund të kërkojmë disiplinë nga qytetarët. Peja nuk mund të pretendojë zhvillim dhe turizëm ndërkohë që hyrja dhe periferia e saj shndërrohet në deponi. Kjo situatë kërkon veprim dhe angazhim serioz. Kujdes të shtuar nga ana e qytetarëve që mos të ndotin ambientin dhe plan të qartë nga ana e kryetarit dhe ekzekutivit për të siguruar një Pejë të pastër.

Z. Berat Ganiqi: një sugjerim për drejtorin e shërbimeve publike, fjala është për të rrethi të Kondirolli! Drejtor, mundësisht vendkalimi për këmbësor, ato vijat ku janë duheni me i heq për shkak që po krijon telashe të reja të vendkalimit edhe po i rrezikon këmbësor, por të njëjtën kohë edhe po shkakton tollovi në komunikacion. Është mirë ato vija dhe të rregullohet një komunikacion pak më ndryshe në kuptimin që mos t'ju japet përparësi këmbësorëve, në rreth të kalojnë për shkak të këtyre telasheve që i cekta.

Nënkryetari Fatmir Asllani: po i përgjigjina edhe këtyre dy pyetjeve të fundit të Arditi. Komuna vitin e kaluar e ka propozuar para asamblesë është votuar një listë. Janë nda tre parcella në fshatin Sferk, zona katastrale Llutogllavë Mirëpo është mbetur të formohet një komision prej komunës që do ta bëjë edhe shpalljen e procedurave të ankandit që dikush duhet me i marrë me i menaxhu ato. Domethënë lokacioni është ndarë. Janë tre parcella nga një hektarë. Një është për materiale inerte të forta, një është për goma dhe një është për mobile. Po ende komuna nuk e ka formuar një komision që do ta bëjë përzgjedhjen atyre operatorëve që kanë me i mirëmbajt ato dhe kanë me u kujdes për to. Aty tani do të caktohen edhe tarifatat e hudhjes që ne kemi kërkuar me qenë tarifatat minimale veç sa për simbolike, që me i stimulu sa më shumë qytetarët me me shku me i vendos ato mbeturina atje mos me thënë që është tarifa e lartë edhe prapë me na ndodh kjo kjo gjë. Po shpresojmë se gjatë këtij viti do të zgjidhet ky problem, nuk do të shkojë periudha ndoshta shumë më e gjatë dhe do të jemi në kordinim tamam me kohë që të jetë një pikë



Handwritten signature or mark in blue ink.

referuese ku kanë me u adresuar qytetarët. Sigurisht që informimi do të jetë edhe edhe përmes mediave, përmes rrjeteve sociale, adresa, do të vendoset pika ku kanë me u hodhë këto mbeturina. Tash këtu pjesa e eliminimit të deponive ilegale është sfidë për neve prapë pa u formuar deponi atje dhe pa u funksionalizuar edhe ne nuk mundem me i mbledh me i grumbullu aty. Sa i perket pyetjes së Beratit e kemi parë edhe më herët ka qenë si problem, e kemi vrejt si detaj po jemi në përzgjedhje të operatorit edhe e kryejmë!

Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime tjera nuk ka pasur, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të kuvendit, në orën **13:40** h.

Video incizimi i këtij takimi të Kuvendit të Komunës së Pejës në kanalën zyrtarë në Youtube.

Kliko: <https://www.youtube.com/watch?v=qArYl-lhY4A>

Procesmbajtësja,
znj. Donjeta Morina

